

Komisioneri për Mbrojtjen  
nga Diskriminimi

Commissioner for Protection  
from Discrimination

# RAPORT MONITORIMI ME FOKUS TË VEÇANTË FËMIJËT NË ARSIM

2020

## Tabela përmbledhëse

HYRJE .....	4
BAZA LIGJORE .....	5
QËLLIMI .....	9
METODOLOGJIA .....	10
INSTRUMENTI .....	10
KUFIZIME TË METODOLOGJISË.....	10
ANALIZA E TË DHËNAVE .....	10
Fëmijët me aftësi të kufizuara të përfshirë në arsim. ....	11
Fëmijë romë dhe fëmijëve egjiptianë të përfshirë në arsim. ....	21
Aspekte të monitorimit të detyrimeve ligjore.....	29
KONKLUZIONE .....	33
REKOMANDIME .....	36

## AKRONIME

DRAP - Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar

AK - Aftësi e kufizuar

DAR - Drejtoria Arsimore Rajonale

IAP - Institucione Arsimore Parauniversitare

PEI - Plan Edukimi Individua

ZA - Zyrë Arsimore

ASHDMF - Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

INSTAT - Instituti i Statistikave

IPSH - Institucionet e përkujdesit shoqëror

OJF - Organizatë jofitimprurëse

**“Respektojmë  
të drejtat  
e fëmijëve,  
garantojmë  
të ardhmen”**

## HYRJE

Fëmijët gëzojnë disa të drejta themelore të cilat duhen respektuar.

Përpjekja e parë për të pasur të drejta të strukturuar për fëmijët regjistrohet në vitin 1924 në Gjenevë me deklaratën “Për të drejtat e fëmijëve” e cila në vitin 1959 u njoh në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave Civile dhe Politike, si dhe në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Kulture dhe Sociale.

Gjithashtu, parashikohet ngritja e instrumenteve, por dhe organizmave ndërkombëtarë që i kushtojnë vëmendje mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Në vitin 1989 Organizata e Kombeve të Bashkuara aprovon Konventën për të Drejtat e Fëmijëve<sup>1</sup> duke përcaktuar të drejtat themelore për fëmijët. Këto janë: e drejta për të jetuar, për ushqim, kombësi, emër; e drejta për zhvillim, edukim argëtim; e drejta për mbrojtje nga abuzimet dhe e drejta e shprehjes së lirë të mendimit.

Në lidhje me të drejtën për zhvillim edukim përkujdesje dhe argëtim, çdo fëmijë gëzon të drejtën për t’u zhvilluar dhe për të eksploruar kapacitetet e tij plotësisht. Edukimi në këtë rast nuk mund të limitohet vetëm tek mësimdhënia, por është më i gjerë dhe lidhet me kulturën dhe me vlerat njerëzore universale të tolerancës miqësisë midis kombeve, racave të ndryshme apo grupeve fetare.

Të gjithë fëmijët duhet të mësojnë së bashku, pavarësisht ndryshimeve dhe sfidave të tyre.

### E drejta për arsimim

E drejta për arsimim për të gjithë fëmijët, edhe pse është e përfshirë në legjislacion, duket se krijon një konflikt me praktikën dhe strukturat e shoqërisë shqiptare. Mungesa e atmosferës bashkëpunuese e bashkëvepruese, përfshirëse, në shoqëri dhe në shkollë ndikon negativisht në formimin e personalitetit të fëmijës.

Nëse një fëmijë beson se gjatë fëmijërisë së tij është privuar nga eksperiencat e bukura ose nuk ka qenë i pranuar nga të tjerët atëherë krijohet një impakt negativ në lidhje me mënyrën se si fëmija do të përshtatet në komunitet, por edhe me ndjenjën e përkatësisë, pasi fëmija e ka të vështirë të ndihet pjesë e komunitetit<sup>2</sup>.

Studimet e fundit<sup>3</sup> në lidhje me fëmijët tregojnë se një fëmijë është shumë më i lumtur kur ndërvepron me të tjerët, shokët miqtë apo me një të rritur tek i cili ai ka besim se sa kur ai kalon një fëmijëri të vetmuar duke luajtur vetë me lodra apo duke parë televizor e kompjuter.

Diversiteti mes nxënësve nuk nënkupton vetëm nxënësit me aftësi të kufizuara, por të gjithë ata që janë të ndryshëm për shkak të preajardhjes së tyre, përkatësisë, kulturës, siç mund të jenë nxënësit nga komuniteti rom dhe egjiptian, nxënësit që vijnë nga familje me të ardhura të pakta, apo të natyrës gjinore, etj.

Një shoqëri me kaq shumë informacion dhe sfida, kërkon nisma sensibilizuese rreth vlerave që mund të kenë ata që duken “ndryshe”, si romët dhe egjiptianët, personat me aftësi të kufizuara, apo çdo grup shoqëror që për një arsye apo tjetër konsiderohet ndryshe në një kontekst të caktuar.

<sup>1</sup>[ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx](http://ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx)  
<sup>2</sup>[tandfonline.com/doi/pdf/10.3402/ijch.v63i0.17911](http://tandfonline.com/doi/pdf/10.3402/ijch.v63i0.17911)

<sup>3</sup>[psychologytoday.com/us/blog/longing-nostalgia/201201/childhood-happiness-more-just-children-play#:~:text=Family](http://psychologytoday.com/us/blog/longing-nostalgia/201201/childhood-happiness-more-just-children-play#:~:text=Family)

## Arsimi gjithëpërfshirës

Arsimi gjithëpërfshirës nënkupton nxënës të ndryshëm dhe të veçantë që mësojnë së bashku në të njëjtën klasë. Sistemet gjithëpërfshirëse ofrojnë një arsim më cilësor për të gjithë fëmijët dhe janë instrumentalë për sa i përket ndryshimit të qëndrimeve që mund të gjenerojnë sjellje diskriminuese.

Vitet e fundit, shërbimi arsimor në Shqipëri është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme. Institucionet parashkollore dhe ato shkollore janë forcuar në formë e në përmbajtje. Arsimi për të gjithë ka qenë gjithmonë një pjesë integrale e axhendës së zhvillimit të qëndrueshëm, por ka fituar më shumë vëmendje në Axhendën për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030, ku qëllimi i katërt i referohet: “Sigurimit të arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë, dhe promovimit të mundësive të të nxëniet gjatë gjithë jetës për të gjithë”<sup>4</sup>. Ai thekson eliminimin e pabarazive gjinore në arsim dhe sigurimin e aksesit të barabartë për të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimin profesional për fëmijët vulnerabel.

Megjithëse parimi i arsimit gjithëpërfshirës është pranuar gjerësisht në institucionet arsimore dhe legjislacion, zbatimi i tij ndeshet me pengesa të shumta.

Gjithëpërfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin bazë ngelet ende një sfidë për integrimin e tyre.

Shkolla duhet të reflektojë komunitetet që ka shoqëria, pasi kjo i ndihmon fëmijët për t'u rritur dhe për të pranuar shumëllojshmërinë e shoqërisë, si dhe për të mos diskriminuar individë apo grupe të ndryshme.

## BAZA LIGJORE

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, sanksionon në nenin 18 të saj se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ka sanksionuar se, kushdo ka të drejtën për arsimim, arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj, arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë dhe arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kriteret aftësie.

**Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës**, e cila është ratifikuar nga vendi ynë, në vetvete përbëhet nga një numër standardesh dhe detyrimesh të panegociueshme, për të cilat është rënë dakord botërisht, në mënyrë që të ofrohet mbrojtje dhe përkrahje për të drejtat e fëmijëve.

Neni 28 – Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë; inkurajojnë zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm si të përgjithshëm, dhe profesional, i bëjnë ato të hapura e të mundshme për çdo fëmijë dhe marrin masa të përshtatshme, si vendosja e arsimit falas dhe dhënia e një ndihme financiare në rast nevojë; u sigurojnë të gjithëve arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme; bëjnë të mundshëm dhe të arritshëm për çdo fëmijë informacionin dhe orientimin shkollor e profesional; marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

<sup>4</sup>[sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld/publication](https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld/publication)

**Konventa Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK)**, e cila është ratifikuar nga vendi ynë, i ofron mbrojtje personave me aftësi të kufizuara, duke ndryshuar para së gjithash, trajtimin e aftësisë së kufizuar nga ai bazuar në modelin mjekësor, në trajtimin sipas modelit social. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe t'u sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

Parimi i mosdiskriminimit është një ndër parimet e kësaj Konvente, ku ofrohet një mbrojtje e veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara, për të siguruar që këto fëmijë të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut njësoj si të gjithë fëmijët e tjerë.

Në kuptim të kësaj Konvente, personat me aftësi të kufizuara përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.

Neni 24 - Shtetet Palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për arsim. Me qëllim realizimit të kësaj të drejte pa diskriminim dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, Shtetet Palë do të garantojnë një sistem arsimor përfshirës në të gjitha nivelet.

**Ligji nr. 93/2014 "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara"**, i cili është miratuar në frymën e KDKPAK, ka si qëllim sikurse shprehet dhe neni 1 i tij të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Për të mundësuar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët. Sipas nenit 5, pikës 2, germa "b" të ligjit nr. 93/2014, parashikohet se: *"Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim,..."*. *"Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht: ...b) në shkollat e zakonshme dhe të studiojnë në shkollën për të cilën dëshirojnë..."*.

**Ligji nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"**, jepet përkufizimi i termit "nxënës", duke mos vendosur asnjë lloj kriteri apo shkaku që mund të kategorizojë një subjekt, apo ta diskriminojë atë, pra termi është i përgjithshëm duke i mundësuar çdo individ të drejtën për t'u arsimuar.

Nenin 2 pika 16 dhe 17, *"Nxënës" është personi që arsimohet në arsimin parauniversitar*. Ndërkohë Neni 5 (E drejta për arsimim) parashikon të drejtën e mosdiskriminimit për shkak të racës, ngjyrës apo etnisë, në të drejtën për arsimim dhe në shkollat publike arsimit të detyrueshëm dhe arsimit të mesëm i lartë janë falas.

Në nenin 6, *"Parime të Përgjithshme"*, thuhet, ndër të tjera, se: *"...Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi, që mund t'u shkaktojë diskriminim ..."*.



*“Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj...”*.

Neni 10, parashikon të drejtën që kanë pakicat kombëtare (si romë apo egjiptianë) për të mësuar në gjuhën e tyre amtare, *u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre, sipas planeve dhe programeve mësimore.*

Neni 20, Institucionet arsimore vendore, *u sigurojnë shërbim psiko-social nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore, si dhe shërbimi psiko-social ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor”*.

Neni 63, Parime të arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, ndër të tjera parashikon *“...Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet e arsimit special për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me AK në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore”*.

Nxënësve me aftësi të kufizuara në dëgjim, shikim dhe komunikim *u garantohet e drejta e edukimit në gjuhën e shenjave, e drejta e përdorimit të shkrimit Brail...”*.

Për të përcaktuar saktësisht, nëse një fëmijë me AK, duhet të ndjekë një institucion arsimor të specializuar apo një shkollë të zakonshme të arsimit bazë, aplikohet neni 64, pika 3, *“...Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, krijon një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me AK, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar”*.

Në nenin 68, parashikohet *“Mosregjistrimi dhe mungesat e paarsyeshme të fëmijës në mësim për më shumë se 25 për qind të orëve mësimore gjatë një viti shkollor vlerësohen si rast i neglizhencës prindërore dhe trajtohen në përputhje me ligjin nr. 10 347, datë 4.11.2010, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”*.

**Ligji Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”** ka përcaktuar se *“Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm. Prindi ose kujdestari merr masa të përshtatshme që fëmija të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose nivele të tjera të arsimit, sipas dëshirës së fëmijës, si dhe të garantojë frekuentimin e rregullt të tij dhe pa pengesa.*

**Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”**, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me moshën, ku përfshihen fëmijët, dhe ndalon diskriminimin shprehimisht në fushën e arsimit. Në këtë kuadër, përcaktohen detyrime specifike për marrjen e masave me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin, ndër të tjera: për rritjen e ndërgjegjësimit për këtë ligj në sistemin arsimor, përfshirjen në programet mësimore të koncepteve dhe veprimeve kundër modeleve të sjelljes diskriminuese, arsimimin e të gjithë popullsisë, në mënyrë të veçantë, duke marrë masa në favor të grave dhe vajzave, pakicave, personave me aftësi të kufizuara, si dhe personave që janë, ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit si dhe respektimin dhe sigurimin e së drejtës për arsimim në gjuhët e pakicave dhe në mënyrat e përshtatshme për persona me aftësi të kufizuara.

**Vendim nr. 11 datë 11.1.2016 "Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, për Periudhën 2014 - 2020".** Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 (në vijim, SZHAPU) është një nga përbërësit e Planit Strategjik të Arsimit 2014-2020. Ajo ndjek Strategjinë Kombëtare të APU-së 2009-2013 dhe i shërben përsosjes së sistemit arsimor që vlerësohet një nga promotorët e zhvillimit të vendit dhe të përpjekjeve tona integrale.

Strategjia e hartuar pajtohet me prirjet kryesore të zhvillimit të arsimit në Evropë dhe në botë. Si e tillë, ajo synon: i) të përmirësojë cilësinë e arsimit për të gjithë; ii) të identifikojë veprimtaritë kryesore dhe të planifikojë buxhetet e nevojshme; iii) të ndihmojë bashkëpunimin mes agjencive qeveritare, partnerëve tanë dhe grupeve të tjera me interes ndaj arsimit, në drejtim të shtrirjes së veprimtarive dhe të investimeve në arsim, në kufijtë e një kuadri të njësuar konceptimi, planifikimi dhe financimi.

Bazuar në këtë dokument, zhvillohen planet operuese për secilin vit, në të cilët përcaktohen objektivat vjetorë, veprimtaritë konkrete dhe mjetet/burimet përkatëse.

**Vendim nr. 561, datë 29.9.2018 "Për Pajisjen me Tekste Shkollore të Nxënësve, Formimin Fillestar, Zhvillimin e Mëtejshëm Profesional të Mësuesve, si dhe Krijimin e Funksionimit të Klasave në Gjuhën e Pakicave Kombëtare",** parashikon dhe garanton në mënyrë specifike të drejtën e pakicave kombëtare (ku përfshihen edhe nxënësit romë dhe egjiptianë,) për tekste shkollore falas, e në veçanti të drejtën e tyre për zhvillimin e mësimin në gjuhën e tyre, gjithmonë pa cënuar mësimin e gjuhës shqipe.

**Vendim nr. 776, datë 26.12.2018 "Për Kuotat Financiare të Ushqimit në Mensa e Konvikte, Përcaktimin e Kriteve për Përfitim të Bursave dhe Pagesave për Nxënësit e Arsimit Parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike,**

**për Vitin Shkollor 2018 - 2019",** parashikon se: *"Nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kriteve, si më poshtë vijon:*

*"...Jashtë kriterit ekonomik: dh) Nxënës të komunitetit rom dhe egjiptian që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional; "...Nxënësit e komunitetit rom dhe egjiptian që vazhdojnë studimet në shkollat e mesme profesionale, përfitojnë, falas, veshmbathje, libra dhe fletore, sipas kuotës financiare të përcaktuar në pasqyrën nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.*

**Vendim nr. 873, datë 14.12.2016 "Për Kuotat Financiare të Ushqimit në Mensa e Konvikte, Përcaktimin e Kriteve për Përfitim të Bursave dhe Pagesave për Nxënësit e Arsimit Parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike, për Vitin Shkollor 2016 - 2017".** Në bazë të këtij vendimi, nxënësit, që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim, nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në vecanti nxënësit e komunitetit rom dhe egjiptian përfitojnë bursa, veshmbathje, libra dhe fletore.

**Vendim Nr. 708, datë 26.8.2015, "Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor".** Sipas këtij vendimi, institucionet e pavarura, institucionet e administratës shtetërore, bashkitë dhe qarqet mbledhin të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar, sipas fushave ku operojnë, me qëllim hartimin, përmirësimin dhe zbatimin e politikave në mbështetje të programeve të aksesit dhe të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara.



**Plani Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016 – 2010**, i cili në qëllimin strategjik 4, ka përcaktuar se: *“Të sigurohet arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara*. Në objektivin 1 të këtij qëllimi ka përcaktuar se: *“Përmirësimi i cilësisë së arsimit gjithëpërfshirës dhe forcimi i kapaciteteve të mësimdhënies për fëmijët me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara”*. Thelbi i reformave në këtë sektor do të përbëhet nga futja e komisioneve multidisiplinare të arsimit, futja e mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara që studiojnë në shkolla të zakonshme dhe përgatitja e materialit të ri didaktik. Do të vendoset ndjekja individuale dhe koordinimi midis ministrive të ndryshme, me qëllim që të garantohet arsimimi i çdo fëmije me aftësi të kufizuar”.

**Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020**, vjen si një dokument politik i qeverisë shqiptare që adreson problematikat dhe çështjet kryesore që ndikojnë në jetën e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane duke krijuar shpeshherë diferenca në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë. Matrica e Planit Kombëtar të Veprimit përshkruan qëllimet, objektivat dhe aktivitetet, afatet e zbatimit, autoritetet përgjegjëse për zbatim dhe kontroll, vlerat e treguesve dhe pikës së nisjes, burimet e informimit, dokumentet strategjik përkatës, si dhe fondet e nevojshme për zbatimin e Planit të Veprimit.

Matrica është e ndarë në gjashtë sektorë prioritarë, specifikisht pika 2 parashikon: *“Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor”*.

## QËLLIMI

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në funksion të veprimtarisë së tij për promovimin e një shoqërie me mundësi dhe shanse të barabarta dhe duke luftuar çdo veprim apo mos veprim që sjell diskriminim, si dhe në përmbushje të angazhimit të posaçëm të kërkuar nga Kuvendi i Shqipërisë në Rezolutën e vitit 2019 adresuar Komisionerit për Mbrojtjen nga diskriminimi (KMD), për monitorimin me fokus të veçantë fëmijët në arsim, synon të konstatojë në mënyrë që të ndërmerren të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe fëmijëve të pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane, për t’i garantuar të drejtën për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin.

Qëllimi i këtij studimi është paraqitja e situatës të pasqyruar nga informacioni i mbledhur nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP), në lidhje me respektimin e Ligji nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” në kombinim me Ligjin Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, duke konstatuar, por dhe duke propozuar e rekomanduar zgjidhje për rregullimin e situatave problematike.

Synimi kryesor i këtij studimi është pikërisht sigurimi i këtyre të dhënave, pasi pritet që arritjet, gjetjet dhe rekomandimet e tij të lehtësojnë punën për një planifikim më cilësor dhe tërësor të programeve të duhura të cilat ofrojnë një mbrojtje më të mirë të të drejtave të fëmijëve në arsim.

## METODOLOGJIA

Metodologjia e këtij raporti u hartua nga Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Për të përmbushur qëllimin e këtij monitorimi u hartua pyetësori për përgatitjen e raportit të monitorimit për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsim për vitin shkollor 2018 - 2019 dhe 2019 - 2020.

Pyetësori u mbështet në pjesën më të madhe në përmbajtjen e VKM Nr. 708, datë 26.8.2015 "Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor".

Pyetësori u dërgua në katër Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP), Durrës, Fier, Lezhë dhe Korçë. Me qëllim studimin e situatës në zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi me fokus të veçantë fëmijët në arsim, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët romë, fëmijët egjiptianë për ecurinë në arsim për vitin shkollor 2018 - 2019 dhe 2019 - 2020.

Gjithashtu, disa të dhëna u përdorën nga Instat.

## INSTRUMENTI

Për të mbledhur të dhënat nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar në interes të objektivave të vlerësimit u hartua pyetësori për përgatitjen e raportit të monitorimit me fokus të veçantë fëmijët në arsim.

Ky pyetësor u dërguan edhe në formë elektronike në institucionet përgjegjëse ku përveç plotësimit të pyetësorit u kërkua të bashkëngjitej çdo dokument tjetër që DRAP-të e shohin me interes për t'u përmendur në raport.

Për të kuptuar më mire kushtet dhe standartet, si dhe funksionimin e monitorimit të DRAP Durrës, Fier, Lezhë dhe Korçë për ofrimin e arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara

dhe fëmijëve romë dhe egjiptianë e kemi ndarë këtë pyetësor në tre seksione, sipas modelit në Anex 1:

- ✚ Fëmijë me aftësi të kufizuara në arsim.
- ✚ Fëmijë rom dhe egjiptian në arsim.
- ✚ Aspekte të monitorimit të detyrimeve ligjore.

## KUFIZIME TË METODOLOGJISË

Metodologjia e ndjekur në këtë monitorim paraqet kufizime edhe pse janë hartuar politika adekuate që adresojnë çështje për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe të pakicave kombëtare si romët dhe egjiptianët. Në disa raste përgjigjet nga institucionet përgjegjëse ishin të pamjaftueshme ose nuk i korrespondonin pyetjeve konkrete, si dhe nuk kishte mekanizëm raportimi me tregues të standardizuar. Gjithashtu, jo në të gjitha pyetjet u ofruan informacion konkret dhe i qartë nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar.

Informacioni i dërguar nuk është konfrontuar me mënyra tjera informacioni duke bërë që rezultatet e monitorimit të jenë ekskluzivisht frut i informacionin të dërguar nga DRAP-të.

## ANALIZA E TË DHËNAVE

Të dhënat e ofruara nga të gjitha institucionet përgjegjëse, u përpunuan sipas metodave cilësore të përpunimit, duke grupuar të dhënat për aq sa informacioni lejonte, për çdo aktivitet, pyetje, duke vënë në dukje progresin e arritur, sikurse u raportua nga çdo institucion.

Burim kryesor informacioni ishin katër Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar.

Hedhja e të dhënave u realizua paralelisht me procesin e mbledhjes së të dhënave, por theksojmë se informacioni ishte jo shpesh i përputhshëm me tabelat e dërguara me të dhënat e dërguara po nga vetë këto institucione, si dhe nuk i përgjigjeshin të gjitha pyetjeve konkrete të pyetësorit.

## Fëmijët me aftësi të kufizuara të përfshirë në arsim.

### Fëmijët me aftësi të kufizuara në nivele të ndryshme të arsimit

Të regjistruar në arsim për vitin shkollor 2018 - 2019 janë në arsimin bazë 306.530 fëmijë dhe në arsimin e mesëm janë 116.646 fëmijë. Për vitin shkollor 2019 - 2020 janë në arsimin bazë 294.879 fëmijë dhe në arsimin e mesëm janë 108.061 fëmijë<sup>5</sup>.

Në **DRAP Durrës** numri i nxënësve me aftësi të kufizuara në Institucionet Arsimore (IA) për vitin shkollor 2018 - 2019 është 648 nxënës me aftësi të kufizuara intelektuale, 162 nxënës me aftësi të kufizuara fizike, pra në total 810 nxënës me aftësi të kufizuar. Për vitin shkollor 2019 - 2020 është 767 nxënës me aftësi të kufizuara intelektuale dhe 195 nxënës me aftësi të kufizuara fizike, pra 962 nxënës në total.

Në **DRAP Fier** për vitin shkollor 2018 - 2019 kanë ndjekur mësimin 547 nxënës me aftësi të kufizuara, ndërsa në vitin shkollor 2019 - 2020 kanë ndjekur mësimin në shkolla 731 nxënës me AK, 599 nxënës me aftësi të kufizuara intelektuale dhe 132 nxënës me aftësi të kufizuara fizike.

Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara në **DRAP Lezhë** për vitin shkollor 2018 - 2019 është 518 nxënës, ndërsa në vitin shkollor 2019 - 2020 është 531 nxënës, 428 nxënës me aftësi të kufizuara intelektuale dhe 132 nxënës me aftësi të kufizuara fizike.

Në **DRAP Korçë** për vitin shkollor 2018 - 2019 kanë ndjekur mësimin 789 nxënës me aftësi të kufizuara, ndërsa në vitin shkollor 2019 - 2020 kanë ndjekur mësimin në shkolla 804 nxënës me AK, 610 nxënës me aftësi të kufizuara intelektuale dhe 194 nxënës me aftësi të kufizuara fizike.




Figura 1. Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara në Institucionet Arsimore




Figura 2. Lloji i aftësisë së kufizuar në Institucionet Arsimore për vitin shkollor 2019 - 2020

Siç evidentohet në të gjitha DRAP-të ka patur një numër në rritje të nxënësve me aftësi të kufizuar nga viti shkollor 2018/2019 në vitin 2019/2020 dhe ka një predominim të fëmijëve me aftësi të kufizuar intelektuale.

Nuk është vënë në dispozicion nga DRAP-të numri i nxënësve në total në arsimin bazë dhe të mesëm në juridiksionin e tyre.

<sup>5</sup> Instat

## Nxënës në nivele të ndryshme të arsimit për vitin shkollor 2019 - 2020, ndarja e gjinisë

Në DRAP Durrës numri i nxënësve me aftësi të kufizuara në Institucionet Arsimore për vitin shkollor 2019-2020 është, në arsimin bazë 850 fëmijë nga të cilët 588 janë femra dhe 262 janë meshkuj. Në arsimin e mesëm janë 182 fëmijë nga të cilët 78 janë femra dhe 104 janë meshkuj. *Ka mospërputhje të shifrave të deklaruara në shkresë dhe atyre në tabelë.*

Në DRAP Fier për vitin shkollor 2019 - 2020 kanë ndjekur mësimin në arsimin bazë 629 fëmijë nga të cilët 192 janë femra dhe 437 janë meshkuj. Në arsimin e mesëm janë 102 fëmijë nga të cilët 32 janë femra dhe 70 janë meshkuj.

Në DRAP Korçë për vitin shkollor 2019 - 2020 në arsimin bazë kanë ndjekur mësimin 734 nxënës me aftësi të kufizuara, nga të cilët 249 janë femra dhe 485 janë meshkuj. Në arsimin e mesëm janë 70 fëmijë nga të cilët 34 janë femra dhe 36 janë meshkuj.

DRAP Lezhë për vitin shkollor 2019 - 2020 në arsimin bazë dhe të mesëm janë 531 fëmijë nga të cilët 174 janë femra dhe 357 janë meshkuj. Tabela nga DRAP Lezhë nuk është e ndarë në arsimin bazë dhe të mesëm, afërsisht në arsimin 9 vjeçar kanë ndjekur mësimin 470 nxënës me aftësi të kufizuara, nga të cilët 154 janë femra dhe 316 janë meshkuj. Në arsimin e mesëm janë 61 fëmijë nga të cilët 20 janë femra dhe 41 janë meshkuj. *Ka mospërputhje të shifrave të deklaruara në shkresë dhe atyre në tabelë.*

*Një nga pyetjet e pyetësorit për raportin e këtij monitorimi ishte ndarja e gjinisë së nxënësve, DRAP-të nuk e kanë plotësuar këtë të dhënë, ndaj këto të dhëna janë nxjerrë nga tabelat e dërguara nga DRAP-të, por vërehet një mosrakovim i numrit të nxënësve të deklaruar me numrin e nxënësve të marrë nga tabelat që kanë dërguar po këto drejtori.*

*Gjithashtu, tabelat nuk kanë një format standart në ndarjen e të dhënave për fëmijët me AK.*




Figura 3. Nxënës me aftësi të kufizuara në arsimin bazë për vitin 2019-2020, sipas gjinisë.




Figura 4. Nxënës me aftësi të kufizuara në arsimin e mesëm për vitin 2019-2020, sipas gjinisë.

Raporti në % midis nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e mesëm dhe në arsimin bazë është: DRAP Durrës 21%; DRAP Fier 16%; DRAP Korçë 9.5%.

Siç evidentohet në raportin meshkuj femra midis nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin bazë, ka një numër më të madh të nxënësve meshkuj në tre DRAP, ndërsa vetëm në DRAP Durrës ky raport ndryshon. Në arsimin e mesëm, në të gjitha DRAP-të përveç Lezhës, për të cilën nuk disponohet informacion, meshkujt janë më të shumtë se femrat.

### Fëmijët me aftësi të kufizuara që nuk janë të përfshirë në arsim.

Fëmijët me aftësi të kufizuara të ndarë në nivele të ndryshme të arsimit për vitet shkollore 2018 - 2019 dhe 2019 - 2020, të cilët janë në moshë për ndjekjen e arsimit parauniversitar, por nuk janë të përfshirë në arsim, të ndarë sipas llojit të aftësisë së kufizuar dhe gjinisë janë:

**DRAP Durrës**, në vitin shkollor 2018 - 2019 është 63 nxënës me aftësi të kufizuara intelektuale dhe 18 nxënës me aftësi të kufizuara fizike dhe për vitin shkollor 2019 - 2020 është 80 nxënës me aftësi të kufizuara intelektuale dhe 14 nxënës me aftësi të kufizuara fizike.

**DRAP Fier**, në vitin 2018 - 2019 nuk kanë ndjekur shkollën 16 nxënës, ndërsa në vitin 2019 - 2020 ky numër ishte 17 nxënës.




Figura 5. Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara që nuk janë të përfshirë në arsim për vitin 2019-2020

**DRAP Lezhë**, për vitin shkollor 2018 - 2019 nuk ka ndjekur shkollën vetëm një fëmijë me AK intelektuale e gjinisë femër.

Për vitin 2019 - 2020 janë dy nxënës, një me AK intelektuale dhe një me AK fizike që nuk kanë ndjekur shkollën.

**DRAP Korçë** nuk ka sjellur informacion në lidhje me këtë aspekt.

### Fëmijët që kanë përfunduar nivelet e ndryshme të arsimit parauniversitar.

**DRAP Fier** raporton 3 nxënës të cilët përfunduan arsimin e detyruar për vitin shkollor 2018 - 2019, prej tyre 1 femër dhe 1 me AK intelektuale.

Në vitin 2019 - 2020 përfunduan nivelet të arsimit 25 nxënës me AK, prej të cilëve 17 femra dhe 8 meshkujd, si dhe 23 me aftësi të kufizuara intelektuale 2 me AK fizike).

**DRAP Lezhë**, numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë përfunduar nivelet e ndryshme të arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2018 - 2019 janë 26 fëmijë nga të cilët 4 janë femra me AK intelektuale, ndërsa në vitin 2019 - 2020 janë 18 fëmijë nga të cilët 3 janë femra me AK intelektuale.

*Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës dhe Korçë nuk kanë dhënë informacion për fëmijët me aftësi të kufizuara që kanë përfunduar arsimin parauniversitar.*



### Frekuentimi i shkollave në zonat urbane dhe rurale

**DRAP Durrës**, për vitin shkollor 2018 - 2019 janë 434 nxënës me AK intelektuale në zonat urbane dhe 214 nxënës në zonat rurale dhe 103 nxënës me AK fizike në zonat urbane, 49 nxënës në zonat rurale. Për vitin shkollor 2019 - 2020, nxënës me AK intelektuale janë 496 nxënës në zonat urbane dhe 271 nxënës në zonat rurale, 116 nxënës në zonat urbane dhe 79 nxënës në zonat rurale me AK fizike.

**DRAP Fier**, në vitin mësimor 2019 - 2020 frekuentojnë shkollën, në zonat urbane 429 nxënës me AK dhe në zonat rurale janë 302 nxënës me aftësi të kufizuara.

**DRAP Lezhë**, për vitin shkollor 2019 - 2020, në zonat urbane frekuentojnë shkollën 293 nxënës ndërsa në zonat rurale e frekuentojnë 238 fëmijë me aftësi të kufizuara.

**DRAP Korçë**, në vitin mësimor 2019 - 2020 në zonat urbane frekuentojnë shkollën 364 nxënës me AK dhe në zonat rurale janë 440 nxënës me aftësi të kufizuara.




Figura 6. Viti shkollor 2019 - 2020, nxënësit me AK që frekuentojnë shkollat në zonat urbane dhe rurale




Figura 7. Nxënësit me aftësi të kufizuara që frekuentojnë shkollat në zonat urbane dhe rurale

### Frekuentimi i fëmijëve me AK në shkollë

**DRAP Durrës**, prej 12 vitesh, ka rregullisht nxënës me AK. Këta nxënës kanë ndjekur arsimin e detyruar nga klasa I-rë deri në klasën IX-të, dhe më pak në arsimin e mesëm të përgjithshëm ose profesional. Regjistruar rishtazi janë 430 nxënës dhe të transferuar janë 19 nxënës.

**DRAP Fier**, nxënësit me AK, sipas moshës së tyre, frekuentojnë rregullisht shkollën. Aktualisht nga 731 nxënës në total janë raportuar 3 transferime të nxënësve me AK.

**DRAP Lezhë**, frekuentimi i shkollës nga shumica e këtyre nxënësve është i rregullt, drejtorja pohon që janë 531 nxënës me AK dhe DRAP Korçë që janë 804 nxënës me AK. Vite më parë këta fëmijë ishin të paidentifikuar, por me funksionimin nga viti 2014 e në vazhdim të Komisioneve Multidisiplinare në Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) dhe me mbështetjen e mësuesëve ndihmës, si dhe bashkëpunimin e prindërve është bërë identifikimi dhe vlerësimi i tyre.

## Aksesueshmëria nëpër shkolla

Në DRAP Durrës janë gjithsej 470 shkolla dhe 122 prej tyre janë të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, pra rreth 25%. Ky numër pritet të jetë rritje për faktin se ka një numër të konsiderueshëm shkollash në proces rikonstruksioni apo rindërtimi me qenë se DRAP Durrës ka në juridiksion institucione arsimore të dëmtuara nga tërmeti dhe shkollat që po ndërtohen janë sipas standarteve bashkëkohore që parashikojnë edhe plotësimin e kriterëve për këtë kategori nxënësish.

Institucionet e Arsimit Parauniversitar (IAP) nën juridiksionin e DRAP Durrës, janë në pjesën më të madhe të tyre, të aksesueshme për fëmijët me AK në katet e para të shkollave. Shkollat të ndërtuara vitet e fundit apo të rikonstruktura rishtazi, përgjithësisht kanë rampa të paktën për aksesin në katin e parë, por ka shkolla ku kjo mundësohet që nxënësi të ketë akses në të gjitha katet.

Në rastet kur institucionet arsimore janë të paaksesueshme dhe pranë tyre regjistrohen nxënës me AK, nevojat e këtyre fëmijëve vlerësohen nga Komisioni Multidisiplinar për AK, pranë ZVAP-ve nën juridiksionin e DRAP Durrës, Komision i cili jep rekomandime për IAP-në dhe prindërit në funksion të menaxhimit të rastit në përputhje me nevojat.

Në DRAP Lezhë nga 182 shkolla vetëm 93 shkolla janë të aksesueshme për fëmijët me AK, pra rreth 50%. Aksesin për fëmijët me AK sigurohet me mbështetjen e mësuesit ndihmës, mësuesve të tjerë psikologut të shkollës dhe aktualisht nxënësit e identifikuar me AK nuk paraqesin mungesë aftësie lëvizore sa të jetë e domosdoshme përdorimi i karrocave lëvizëse por, edhe nëse do të ketë ata do të vendosen të gjithë në katet e para të godinave.

Gjithashtu, në ZVAP Shkodër ka një shkollë speciale e cila ka kushte të përshtatshme dhe janë akomoduar pjesa më e madhe e fëmijëve të qarkut Shkodër që kanë AK me të theksuar.

Në DRAP Fier janë 438 shkolla publike 347 prej tyre janë të aksesueshme për nxënësit me aftësi të kufizuara, pra rreth 80%. Në rastet kur ka nxënës në një shkollë që nuk ofron akses të lirë, nxënësit ndihmohen nga prindërit dhe mësuesit për të mundësuar vijimin e procesit mësimor.

Në DRAP Korçë janë 306 shkolla dhe pjesa më e madhe e shkollave janë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara. Kjo nga rikonstruksionet e kryera nga Bashkitë 5 vitet e fundit tek shkollat ku është futur si element i domosdoshëm rampa dhe shkallët e emergjencës.

Tek shkollat ku ka nxënës me AK janë të aksesueshme. DRAP Korçë pohon se në ZVAP Cerrik dhe Gramsh tek shkollat vartëse të fshatrave të largëta u ofrohet arsimi në shtëpi duke qenë se këto shkolla ende nuk kanë hyrë në proces rikonstruksioni.




Figura 8. Shkolla të aksesueshme për nxënësit me aftësi të kufizuara sipas DRAP-ve.

Në total rezulton se vetëm 60% e shkollave në Republikën e Shqipërisë garantojnë aksesueshmërinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara, jo në të gjithë strukturën e tyre por në pjesën më të madhe vetëm në katet e para të godinave.

## Mësues ndihmës

**DRAP Durrës** pohon se kanë nevojë për mësues ndihmës 962 nxënës më AK dhe janë aktualisht 341 mësues ndihmës që trajnohen në rrjetet profesionale, në agjensi të akredituara privatisht, psikologjia e shkollës ose punonjësi social nga ASCAP. Pra, një mësues ndihmës për 3 fëmijë me AK.

**DRAP Fier**, për vitin shkollor 2019 - 2020 ka 698 nxënës me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për mësues ndihmës dhe janë 345 mësues. Këta mësues janë trajnuar kryesisht në agjenci trajnuese private, për t'u certifikuar për mësimdhënie me këtë kategori fëmijësh. Një pjesë e mësuesve ndihmës kanë përfunduar fakultetin për Pedagogji Speciale. Një mësues ndihmës për 2 fëmijë me AK.

**DRAP Lezhë** ka të identifikuar fëmijë me AK që kanë nevojë për mësues ndihmës për 531 nxënës dhe ka 161 mësues ndihmës në shkolla. Trajtimi i mësuesve ndihmës realizohet nëpërmjet rrjeteve të tyre profesionale si, ASCAP, Agjencive që ofrojnë module të tilla, organizata joqeveritare Eorld Vision, METPAK etj. Pra, një mësues ndihmës për 3 fëmijë më AK.




Figura 9. Mësues ndihmës në total për vitin 2019-2020, 1051.

**DRAP Korçë** janë 744 nxënës me AK dhe janë 204 mësues ndihmës për vitin shkollor 2019 - 2020, si dhe nuk ka informacion për trajnimin e këtyre mësuesëve ndihmës. Pra, një mësues ndihmës për 4 fëmijë me AK.

## Shpërndarja e fëmijëve me AK në klasa

**DRAP Durrës** thekson se drejtoritë e shkollave janë munduar që t'i shpërndajnë fëmijët me AK nga një në klasë duke respektuar moshën dhe nivelin e arsimit. Nëse kjo nuk është e mundur për shkak të numrit të lartë të nxënësve AK në një nivel, ndarja bëhet duke vlerësuar numrin e nxënësve në klasë, eksperiencën e mësuesit dhe nevojat arsimore të fëmijëve më AK që mund të caktohen në të njëjtën klasë.

Për ndarjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara mbahet në vëmendje raporti i barabartë ndërmjet mësuesëve, bëhet kujdes që mësueset e trajnuara të bashkëpunojnë me kolegët, psikologun dhe prindin. Nga ZVAP-të në bashkëpunim me shërbimin psiko-social dhe drejtoritë e shkollave është kërkuar që këto nxënës të trajtohen dhe të përfshihen në mënyrë të barabartë me shokët e klasës.

**DRAP Fier** thekson se nxënësit me aftësi të kufizuara janë shpërndarë sipas klasave ku u takon të ndjekin mësimin. Në përgjithësi kjo kategori nxënësish, kur shkollat kanë klasa paralele, janë shpërndarë në mënyrë që të mos ketë më shumë se 1 nxënës me AK në një klasë.

Në të gjitha shkollat që mbulon **DRAP Lezhë** dhe **DRAP Korçë** vendosja e fëmijëve me AK nëpër klasa nuk bëhet asnjëherë e veçuar, por shpërndarja bëhet sipas përcaktimeve të parimit të gjithëpërfshirjes pa diskriminuar, grupuar apo veçuar për shkak të aftësive ndryshe.

## Vazhdimësia e mësuesëve ndihmës

Ndërprerja e asistencës të nxënësve për nxënësit me AK nga mësues ndihmës në disa shkolla **DRAP Durrës** e motivon me arsye të ndryshme, si: mbarimi i kontratës, mungesë kuadri me fond page dhe mos përshtatje ndërmjet mësuesit dhe prindit.

**DRAP Fier** ka të evidentuar 6 raste, për 3 prej tyre arsyeja ka qenë mosrinovimi i raportit mjekësor nga KMCAP dhe 3 raste kur asistenca është ndërprerë me kërkesën nga prindërit.

Ndërsa **DRAP Lezhë** nuk raporton raste të ndërprerjes së asistencës me mësues, por ka pasur ndonjë ndryshim të sasisë së orëve në varësi të progresit të nxënësve nga vlerësimet vjetore të aftësisë e progresit të tyre. Nxënësit janë trajtuar sipas nevojës përcaktuar nga vlerësimi vjetor i komisioneve në ZVAP.

*DRAP Korçë nuk ka dhënë informacion për vazhdimësinë e mësuesëve ndihmës.*

## Nevojat reale të institucionit arsimor për mësues ndihmës

**DRAP Durrës** thekson se sipas numrit të fëmijëve me AK nga IAP-të afërsisht duhen 368 mësues ndihmës, ndërkohë që janë 341 mësues ndihmës.

Nevojat për shtesë të numrit të mësuesve ndihmës janë në rritje, shprehet **DRAP Fier**. Për vitin shkollor 2019 - 2020 nga 3 zyra arsimore është kërkuar shtesë për 7 mësues ndihmës për mbështetjen e nxënësve me aftësi të kufizuara.

Numri i mësuesve që nevojiten realisht për nxënësit me AK në **DRAP Lezhë** është 209 dhe ndërkohë janë 161 mësues.

*DRAP Korçë nuk ka dhënë informacion në lidhje me këtë aspekt.*

## Mësuesit e përgjithshëm për fëmijët me AK

Nga pikëpamja e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve në shkollë mësuesit kanë një bashkëpunim të fortë me punonjësit psiko-socialë dhe prindin. Mësuesit qëndrojnë si një urë lidhëse komunikimi për progresin e fëmijës me AK. Ata mbeten faktorë shumë i rëndësishëm për ndjekjen dhe ecurinë e nxënësit me AK dhe ndërveprimet të tij me bashkëmoshatarët.

**DRAP Durres, Korçë dhe Lezhë** pohojnë se mësuesit e përgjithshëm janë të trajnuar për mësimdhënie për fëmijët me AK. Ata kanë ndjekur trajnime në funksion të zhvillimit të vazhdueshëm profesional.

Ndërsa **DRAP Fier** thekson se nuk ka evidencë të mësuesve të përgjithshëm që janë trajnuar për mësimdhënien me fëmijët me aftësi të kufizuara. Këta mësues, sipas rastit, asistohen dhe trajnohen nga njësia psiko-sociale në shkolla.

## Aksesueshmëria në arsim për fëmijët që nuk shikojnë

Në arsimin e zakonshëm nuk ka libra mësimorë për fëmijët që nuk shikojnë. IAP-të e ZVAP-ve nën juridiksionin e **DRAP Durrës** nuk e kanë infrastrukturën e duhur për nxënësit me probleme në shikim. Mësuesit kujdestar, mësuesit e lëndëve të ndryshme apo edhe mësuesit ndihmës nuk e njohin alfabetin BRAIL. Prindërit, orientohen dhe këshillohen të bashkëpunojnë të paktën për disa vite me Institutin e Nxënësve për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve të tyre. Në të tilla raste merret në konsideratë rekomandimi i Komisionit Multidisiplinar për fëmijët me AK.

Nuk ka pasur në shkolla nxënës që nuk shikojnë, prandaj tekstet e veçanta për ta nuk janë në përdorim, shprehet DRAP Fier. Aktualisht është raportuar vetëm një nxënës që nuk shikon në ZVA Tepelenë - Memaliaj, i cili nuk ka akses në libra të formatit të përshtatshëm për të.

Libra mësimorë për fëmijët që nuk shikojnë nuk ka as në shkollat e **DRAP Lezhë**. Fëmijët që kanë aftësi të kufizuara në shkollat që mbulon DRAP Lezhë nuk kanë shkallë të lartë të mungesës së shikimit, problematikë që me kujdesin e mësuesve është tejkaluar.

**DRAP Korçë** shprehet se nuk jemi furnizuar kurrë me tekste shkollorë për fëmijët që nuk shikojnë dhe shpërndarja e librave bëhet në bazë të VKM nr. 486 dt. 17.06.2020, ku përcaktohet se drejtoritë e shkollave brenda muajit Mars paraqesin në ZVAP-në përkatëse listën e nxënësve që nuk shikojnë dhe porosia dërgohet tek "Instituti i nxënësve që nuk shikojnë" në Tiranë. Deri në momentin që flasim janë përdorur metoda alternative të shpjegimit të mësimin nëpërmjet mësuesit ndihmës.

### Mënyrat e aksesit në mjetet didaktike për fëmijët që nuk dëgjojnë

Për fëmijët që nuk dëgjojnë, në shkollat e **DRAP Durrës**, të cilët janë vlerësuar nga Komisioni Multidisiplinar për AK-të janë rekomanduar mësues ndihmës dhe përdorimi i mjeteve didaktike si: fisha me shkronja, fjalë e numra të shoqëruara me figura, video-projektor, tabela me figura që tregojnë veprime, rregulla, postera, ngjyra, gjuha e trupit, mimika etj. Fëmijët që nuk dëgjojnë përdorin më së shumti gjuhën e shenjave për të komunikuar me stafin arsimor dhe nxënësit në shkollë.

Specifikisht ata kanë nevojë për trajnim në përdorimin e gjuhës së shenjave. Në institucionet arsimore të zakonshme nuk ka mësues që janë të trajnuar për përdorimin e gjuhës së shenjave, po ashtu dhe mësuesit ndihmës.

Nuk ka nxënës që nuk dëgjojnë ndër nxënësit me AK në shkollat e rajonit tonë, pohon **DRAP Fier**. Për këtë arsye, nuk ka qenë i nevojshëm aksesin në mjete didaktike për këtë kategori nxënësish.

Gjithashtu, **DRAP Lezhë** pohon se në asnjë ZVAP nuk ka fëmijë me probleme të theksuar dëgjimi.

### Arsimimi në shtëpi për fëmijët që nuk mund të shikojnë në shkollë

Në shkollat e **DRAP Durrës** për fëmijët të cilët, për nevoja të veçanta të zhvillimit, nuk mund të ndjekin mësimin në institucione arsimore, zhvillimi i mësimin në kushtet e shtëpisë është realizuar vetëm me rekomandim të Komisionit Multidisiplinar për AK pranë ZVAP, duke hartuar Plan Edukimi Individual (PEI) dhe mësimi është zhvilluar me grupe mësuesish sipas lëndëve përkatëse.

Në përgjithësi, fëmijët me aftësi të kufizuara kanë qenë në gjendje të frekuentojnë shkollën për pjesën më të madhe të kohës.

Në shkollat në juridiksionin e **DRAP Lezhë, Korçë dhe Fier** në raste të veçanta, për disa nxënës me AK janë asistuar në shtëpi prej mësuesve ndihmës, sipas orarit dhe grafikut të caktuar nga drejtoritë e shkollave në bashkëpunim me prindërit. Raste të tjera kur nxënës nuk mund të shikojnë në shkolla nuk janë evidentuar.



## Plani Edukativ Individual (PEI)

**DRAP Fier** pohon që për çdo nxënës me aftësi të kufizuara nga ZVA përkatëse janë miratuar PEI të veçanta, ndërsa ZVA Lushnjë ka miratuar një plan model edukativ individual.

PEI të miratuara janë zbatuar në mënyrë korrekte nga mësuesit që punojnë me to dhe janë monitoruar nga drejtoritë e shkollave.

**DRAP Durrës** deklaron të miratuar 983 plane PEI për vitin 2018 - 2019 dhe 1240 plane PEI për 2019 - 2020.

Numri i planeve PEI, në **DRAP Lezhë** të miratuar për vitin shkollor 2018 - 2019 janë 295, ndërsa për vitin shkollor 2019 - 2020 janë 352.

*Vërehet që **DRAP Korçë** dhe **Fier** nuk e kanë numrin e PEI të miratuar nën juridiksionin e tyre.*




Figura 10. PEI të miratuar për vitin shkollor 2019 - 2020

Vërehet edhe një mospërputhje e PEI me numrin e nxënësve me AK në DRAP Durrës dhe Lezhë, numër më i lartë në durrës dhe numër më i vogël në Lezhë.

## Komisione multidisiplinare për vlerësimin e nxënësve me AK

ZVAP-të nën juridiksionin e **DRAP Durrës, Fier dhe Lezhë** kanë Komision Multidisiplinar i cili ka në përbërje të saj mjek, psikolog, punonjës social dhe mësues specialist për AK.

Komisioni kryen rregullisht vlerësimin e nxënësve me AK duke rekomanduar sipas rastit pajisjen me raport mjekësor (në rastet kur fëmija paraqitet pa diagnozë të përcaktuar nga mjeku), llojin e institucionit arsimor (arsim të zakonshëm ose arsim special), si edhe orët që fëmija duhet të punojë me mësues mbështetës.

Komisioni Multidisiplinar i ZVA-ve është funksional dhe realizon sipas udhëzimeve vlerësimin e nevojave arsimore të nxënësve me AK, në bashkëpunim me komisionet AK të shkollave dhe prindërit.

Me përjashtim të ZVA Finiq - Dropull, e cila është e sapokrijuar nga shkrirja e ZVA Delvinë - Finiq, komisioni i mëparshëm ka funksionuar deri në datën 1.8.2020, pohon **DRAP Fier**.

### Raportet nga Komisioni i Institucionit Arsimor pranë Komisionit të DAR/ZA-së

Në **DRAP Durrës** Komisioni i Institucionit Arsimor ka paraqitur 842 raporte ecurie në vitin 2018 - 2019 dhe 1011 raporte ecurie në vitin 2019 - 2020.

Progresi i nxënësve vlerësohet duke ndjekur ecurinë e vazhdueshme me treguesit sipas planit PEI të miratuar, si dhe vlerësimi ndiqet dhe në kontaktet e vazhdueshme mes mësuesit ndihmës, prindit dhe drejtorisë së institucionit.

**DRAP Fier** deklaron se për çdo plan PEI të miratuar është hartuar 2 ose 3 herë në vit një raport i paraqitur pranë Komisionit të DAR/ZA më parë dhe ZVA për vitin 2019 - 2020.

Në këto raporte vlerësohet progresi i nxënësit nga psikologu, prindi dhe mësuesi mbështetës. Progresi i secilit prej nxënësve ka qenë në varësi të diagnozave që ata kanë.

Në **DRAP Lezhë** për viti 2018 - 2019 ka 169 raporte, ndërsa për vitin 2019 - 2020 ka 211 raporte. Evidentohet një nivel i ulët raportimi në këtë DRAP.

*DRAP Korçë nuk e ka dhënë këtë informacion.*

### Covid - 19 dhe mësimi për fëmijët me AK

Gjatë periudhës së Covid-19 janë përshtatur planet PEI për mësim në kushtet e shtëpisë, është zhvilluar mësimi individualisht online nga mësuesit ndihmës me nxënësit me AK.

Në një bashkëpunim shumë të ngushtë mes prindërve, mësuesve dhe mësuesve ndihmës, u bë e mundur që të punohet rregullisht online dhe me nxënësit me AK, pohon **DRAP Durrës**.

Materiale në ndihmë të prindërve për menaxhimin e sjelljeve në kushtet e izolimit dhe video mësimore janë publikuar online në faqet zyrtare të IAP-të.

Ndërsa **DRAP Fier** pohon se nuk ka pasur formate të përshtatura për nxënësit me AK gjatë periudhës së mbylljes së shkollës për shkak të pandemisë. Në procesin mësimor në distancë që u zhvillua në atë periudhë shumë mësues ndihmës dhe njësia psiko-sociale në çdo ZVA ka përshtatur me sa mundësi ka pasur planin e punës me këta fëmijë.

Gjithashtu dhe në **DRAP Lezhë** nuk ka pasur formate të cilësuar, por për të gjithë këta nxënës nga mësuesit ndihmës, psikologët e shkollave, mësuesit kujdestar sipas specifikave të secilit fëmijë kanë zhvilluar komunikimin online nëpërmjet prindërve të këtyre fëmijëve.

*DRAP Korçë nuk e ka dhënë këtë informacion.*

## Fëmijë romë dhe fëmijëve egjiptianë të përfshirë në arsim.

### Fëmijët romë dhe fëmijët egjiptianë në nivele të ndryshme të arsimit

Të regjistruar në arsim për vitin shkollor 2018 - 2019 janë në arsimin bazë 306.530 fëmijë dhe në arsimin e mesëm janë 116.646 fëmijë. Për vitin shkollor 2019 - 2020 janë në arsimin bazë 294.879 fëmijë dhe në arsimin e mesëm janë 108.061 fëmijë<sup>6</sup>.

**DRAP Durrës**, numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë për vitin shkollor 2018 - 2019 është 1822 nxënës romë dhe 1976 nxënës egjiptianë dhe për vitin shkollor 2019 - 2020 është 2794 nxënës romë dhe 2741 nxënës egjiptianë. Evidentohet një rritje e konsiderueshme.

**DRAP Fier**, për vitin shkollor 2019-2020 në juridiksionin e janë regjistruar 714 nxënës romë dhe 1306 nxënës egjiptianë.

**DRAP Lezhë**, për vitin shkollor 2019-2020 janë të regjistruar 267 nxënës romë dhe 539 nxënës egjiptianë.




Figura 11. 2019 - 2020, numri i nxënësve romë dhe egjiptianë në Institucionet Arsimore

**DRAP Korçë**, në vitin shkollor 2018 - 2019 janë regjistruar 825 nxënës romë dhe 3174 nxënës egjiptianë dhe për vitin shkollor 2019 - 2020 janë regjistruar 757 nxënës romë dhe 3339 nxënës egjiptianë. Evidentohet një rënie e konsiderueshme e numrit të nxënësve romë në këtë DRAP.




Figura 12 . Ndarja e fëmijëve romë dhe egjiptianë në Institucionet Arsimore për vitin shkollor 2019 - 2020

### Fëmijët romë dhe egjiptianë që nuk janë të përfshirë në arsim

Numri i fëmijëve romë dhe i fëmijëve egjiptianë në nivele të ndryshme të arsimit në moshë shkollore por të papërfshirë në arsimin parauniversitar për vitin shkollor 2018 - 2019 në DRAP Durrës është 318 fëmijë romë dhe 211 fëmijë egjiptian dhe për vitin shkollor 2019 - 2020 është 211 fëmijë romë dhe 225 fëmijë egjiptian.

**DRAP Fier, Korçë dhe Lezhë** pohojnë se nuk kanë fëmijë romë apo egjiptianë të moshës për ndjekjen e arsimit parauniversitar që të mos jenë të regjistruar.

<sup>6</sup> Instat

### Nxënës rom në nivele të ndryshme të arsimit

Në DRAP Durrës numri i nxënësve rom në Institucionet Arsimore për vitin shkollor 2019 - 2020 është në arsimin bazë 2686 fëmijë nga të cilët 1221 janë femra dhe 1465 janë meshkuj. Në arsimin e mesëm janë 70 fëmijë nga të cilët 33 janë femra dhe 37 janë meshkuj. Raport i ulët arsim baze arsim i mesem, 2.5%.

*Ka mospërputhje të shifrave të deklaruara në shkresë dhe atyre në tabelë.*

Në DRAP Fier për vitin shkollor 2019 - 2020 kanë ndjekur mësimin në arsimin bazë 660 fëmijë nga të cilët 301 janë femra dhe 359 janë meshkuj. Në arsimin e mesëm janë 54 fëmijë nga të cilët 17 janë femra dhe 37 janë meshkuj. Raporti arsim bazë-arsim i mesëm, 8%.

Në DRAP Korçë për vitin shkollor 2019 - 2020 në arsimin bazë kanë ndjekur mësimin 561 nxënës rom, nga të cilët 297 janë femra dhe 264 janë meshkuj. Në arsimin e mesëm janë 56 fëmijë nga të cilët 22 janë femra dhe 34 janë meshkuj.

*Ka mospërputhje të shifrave të deklaruara në shkresë dhe atyre në tabelë.*




Figura 13. Nxënës rom në arsimin bazë sipas gjinisë

Në DRAP Lezhë për vitin shkollor 2019 - 2020 në arsimin 9 vjeçar kanë ndjekur mësimin 266 nxënës, nga të cilët 114 janë femra dhe 152 janë meshkuj. Në arsimin e mesëm është 1 fëmijë i gjinisë mashkull. Raport shumë i ulët arsim bazë arsim i mesëm.




Figura 14. Nxënës rom në arsimin e mesëm sipas gjinisë

*Një nga pyetjet e pyetësorit për raportin e këtij monitorimi ishte ndarja e gjinisë së nxënësve, DRAP nuk e kanë plotësuar këtë të dhënë, ndaj këto të dhëna janë nxjerrë nga tabelat e dërguara nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, por vërehet një mosrakordim i numrit të nxënësve të deklaruar me numrin e nxënësve të marrë nga tabelat që kanë dërguar po këto drejtori.*

## Nxënës egjiptian në nivele të ndryshme të arsimit

Në **DRAP Durrës**, numri i nxënësve egjiptian në Institucionet Arsimore për vitin shkollor 2019 - 2020 është në arsimin bazë 2554 fëmijë nga të cilët 1220 janë femra dhe 1334 janë meshkuj. Në arsimin e mesëm janë 180 fëmijë nga të cilët 74 janë femra dhe 106 janë meshkuj.

Në **DRAP Fier**, për vitin shkollor 2019 - 2020 kanë ndjekur mësimin në arsimin bazë 1164 fëmijë nga të cilët 570 janë femra dhe 594 janë meshkuj. Në arsimin e mesëm janë 142 fëmijë nga të cilët 72 janë femra dhe 70 janë meshkuj.

Në **DRAP Korçë**, për vitin shkollor 2019 - 2020 në arsimin bazë kanë ndjekur mësimin 2559 nxënës nga të cilët 1190 janë femra dhe 1369 janë meshkuj. Në arsimin e mesëm janë 344 fëmijë nga të cilët 178 janë femra dhe 166 janë meshkuj.

Në **DRAP Lezhë**, numri i nxënësve për vitin shkollor 2019 - 2020 në arsimin bazë që kanë ndjekur mësimin është 533 nxënës, nga të cilët 240 janë femra dhe 293 janë meshkuj. Në arsimin e mesëm janë 6 fëmijë nga të cilët 2 janë femra dhe 4 janë meshkuj.

Raport shumë i ulët arsim bazë arsim i mesëm

*Këto të dhëna janë nxjerrë nga tabelat e dërguara nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar por vërehet një mosrakordim i të dhënave të deklaruara me të dhënat e tabelave që kanë dërguar bashkëlidhur pyetësorit.*




Figura 15. Nxënës egjiptian në arsimin 9 vjeçar sipas gjinisë




Figura 16. Nxënës egjiptian në arsimin e mesëm sipas gjinisë



## Shpërndarja e nxënësve romë dhe nxënësve egjiptianë nëpër klasa

Nxënësit romë dhe egjiptianë janë ndarë në klasa në mënyrë të barabartë me nxënësit e komuniteteve të tjera. Politika dhe praktika që janë ndjekur me fëmijët romë dhe egjiptian është mosveçimi nga fëmijët e tjerë në sistemin arsimor. Kështu, në shkollat e IAP-ve të ZVAP-ve nën juridiksionin e DRAP Durrës, nxënësit romë dhe egjiptianë janë të integruar dhe zhvillojnë mësim normalisht me fëmijët e tjerë.

**DRAP Fier** pohon se nxënësit romë dhe egjiptianë shpërndahen në klasa sipas moshës dhe pa krijuar përqendrim të tyre në një klasë të vetme. Shpërndarja e fëmijëve romë dhe egjiptianë është realizuar në mënyrë që ata të integrohen sa me shumë me fëmijët e tjerë në klasë.

Shpërndarja e fëmijëve në shkolla dhe klasa realizohet duke pasur përherë parasysh që këta fëmijë të mos jenë në klasa e shkolla të veçanta, por në shkollat e klasat ku ka dhe nxënës të tjerë. Gjithashtu, kjo shpërndarje lidhet dhe me mundësinë më të mirë të frekuentimit, afërsia me banesat, sigurimi i transportit, mbështetja nga NJMF dhe organizatave OJF, pohon **DRAP Lezhë**.

**DRAP Korçë** thekson se në të gjitha ZVA në varësi, shpërndarja e fëmijëve romë dhe egjiptianë nëpër klasa, në institucionet arsimore, ashtu si shpërndarja e të gjithë fëmijëve të tjerë realizohet në mënyrë uniforme, në klasa të ndryshme sipas grupmoshave, duke zbatuar rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore.

*Këto të dhëna mbeten vetëm të raportuara nga DRAP-të dhe nuk janë të evidentuara në tabela të posaçme për çdo IAP.*

## Shpërndarja e fëmijëve romë dhe fëmijëve egjiptianë në shkolla apo klasa të veçanta

Respektimi i parimit të barazisë mes nxënësve është prioritetet i ZVA-ve dhe IA-ve, thekson **DRAP Durrës**. Nga shkollat realizohet një proces i vazhdueshëm monitorimi i nxënësve romë dhe egjiptian gjatë gjithë vitit shkollor. Ky monitorim realizohet nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm të shkollave me prindërit, mësuesit, nxënësit dhe drejtuesit dhe pasqyrohet përmes statistikave dhe raportimeve mujore nga drejtoritë e IAP-ve. Mjediset edukuese të tyre janë gjithëpërfshirëse. Nxënësit romë dhe egjiptian janë të integruar në klasa, duke u vendosur në hapësira të përbashkëta me nxënësit e tjerë.

**DRAP Fier** shprehet se nuk ka patur raporte monitorimi mbi shpërndarjen e nxënësve romë/egjiptianë në klasa të veçanta, pasi nuk ka pasur në asnjë shkollë probleme të natyrës së segregimit.

Ndërsa **DRAP Lezhë** thekson se monitorimi është i përhershëm dhe realizohet nga të gjitha ZVA-ve duke ndërtuar një sistem statistikor raportimi ku pasqyrohet dhe prezenca e nxënësve romë dhe egjiptianë në klasa dhe shkolla, gjithmonë në fokus të mos ketë segregim.

ZVA-të në varësi dhe **DRAP Korçë** e kanë patur në qendër të vëmendjes shpërndarjen e fëmijëve romë dhe egjiptianë brenda shkollës me qëllim shmangien e segregimit, ku janë integruar të gjithë fëmijët në klasa të zakonshme përmes Udhëzimit të ZVAP për ndarjen e juridiksionit të shkollave. Të gjithë specialistët e ZVAP kanë monitoruar procesin e regjistrimit të nxënësve të klasës së parë në shkolla të ndryshme.

## Fëmijët romë dhe Fëmijët egjiptianë në klasa përgatitore

Në **DRAP Durrës**, Numri i fëmijëve që nuk kanë ndjekur më parë kopshtin është 24 fëmijë romë dhe 12 fëmijë egjiptianë për vitin 2018 - 2019 dhe 25 fëmijë romë dhe 4 fëmijë egjiptianë për vitin 2019 - 2020.

**DRAP Lezhë** pohon se, nuk ka raste të tilla sepse të gjithë fëmijë romë dhe egjiptianë frekuentojnë kopshtet.

**DRAP-të Fier dhe Korçë** të cila nuk kanë informacion për numrin e fëmijëve romë dhe egjiptianë në klasa përgatitore që nuk kanë ndjekur më parë kopshtin.

## Tekste shkollore falas për nxënësit romë dhe nxënësit egjiptianë

Për fëmijët e sistemit parauniversitar romë dhe egjiptianë sipas detyrimit ligjor shpërndarja e teksteve shkollore bëhet falas.

**DRAP Durrës**, raporton se shpërndarja e teksteve shkollore falas për vitin 2018 - 2019 për nxënësit romë është 1883 dhe egjiptianë është 3718, për vitin 2019 - 2020 janë shpërndarë tekste falas për nxënësit romë 1418 tekste dhe egjiptianë 2081.

Raportohet nga **DRAP Fier dhe Korçë** që të gjithë fëmijët romë dhe egjiptianë të regjistruar janë pajisur me tekste shkollore falas. Janë shpërndarë aq tekste falas (paketë tekstesh për lëndët sipas klasës) për fëmijët romë dhe egjiptianë sa numri tyre nëpër shkolla.

**DRAP Lezhë** raporton për vitin shkollor 2019 - 2020 se janë shpërndarë për nxënësit romë 276 dhe egjiptianë 534 tekste falas.

## Identifikimi i fëmijëve romë dhe fëmijëve egjiptianë në moshë shkolle

**DRAP Durrës** pohon se identifikimi i fëmijëve romë dhe egjiptianë në moshë shkolle bëhet ndërmjet verifikimit të listës së 6-vjeçarëve të dërguar nga Zyrat Vendore për regjistrimet e kryera në shkollë, me specialistët për mbrojtjen e fëmijëve pranë Njësive Administrative, grup pune me aktorët përgjegjës pranë Bashkive, informacion nga shoqata "Shkuj" dhe "Adra", informacion nga kopshtet rreth zonës së mbulimit sipas hartës së territoreve, si dhe bashkëpunim me NJMF dhe Komunitetin.

Identifikimi i fëmijëve romë dhe egjiptianë në moshë shkollore, kur ata frekuentojnë shkollën është kryer mbi bazën e vetë-deklarimit të lirë. Në rastet kur këta fëmijë nuk janë regjistruar në shkollë identifikimi nga **DRAP Fier** është realizuar në bashkëpunim me njësitë e mbrojtjes së fëmijëve pranë bashkive, me shoqatat e komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian, si dhe nga informacioni që shkëmbehet me ASHDMF.

**DRAP Lezhë** pohon se identifikimi realizohet vetëm nga shoqatat romë dhe egjiptiane.

***DRAP Korçë** nuk ka dhënë informacion për identifikimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë në moshë shkollore.*

## Fëmijët e paregjistruar në klasë të parë

Për identifikimin e listës për fëmijët e paregjistruar në klasën e parë, sipas zonës që i takon çdo shkollë publike të arsimit bazë sipas juridiksioneve të DRAP-ve për vitin shkollor 2018 - 2019 dhe 2019 - 2020, **DRAP Durrës** përgjigjet se kjo listë identifikohet sipas shkollave.

**Drap Fier** thekson se çdo ZVA ka kryer procesin e identifikimit të fëmijëve që mbushin moshën për regjistrim në shkollat e zonës së mbulimit të tyre dhe e kanë përcjellë informacionin institucioneve të tjera që përfshihen në bazë të marrëveshjes mes tri ministrive.

Përveç identifikimit të rasteve të zakonshme në juridiksionin e **DRAP Lezhë**, ka patur dhe vëzhgime në terren, të mbështetura dhe nga NJMF pranë bashkive përkatëse.

**DRAP Korçë** nuk ka dhënë informacion për identifikimin e listës për fëmijët romë dhe egjiptianë të paregjistruar në klasën e parë.

## Institucionet e përkujdesit shoqëror (IPSH) publike dhe jopublike

Në total janë 27 IPSH publike dhe jo publike, por për vitin 2019 kanë dhënë informacion 18 prej tyre ndërsa 5 institucione jo publike nuk kanë dhënë informacion, 2 prej ISHP deklarojnë se nuk kanë aktivitet rezidencial, ndërsa për 2 institucione është kthyer posta. Sipas të dhënave të dërguara, numri i përgjithshëm i fëmijëve në IPSH është 443, nga këto 148 i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian.

Nga totali prej 148 fëmijë romë dhe egjiptianë të cilët janë të vendosur në ISHP, 109 prej tyre janë fëmijë të cilët kanë familje ndërsa për 39 fëmijë, rezultojnë se

është hequr kujdestaria e prindërve dhe janë vendosur në kujdestari të institucioneve rezidenciale, ndërsa 6 fëmijë janë në pritje të procedurave për vendosje në kujdestari të ISHP-ve.




Figura 17. Fëmijët romë dhe egjiptianë në Institucionet e përkujdesit shoqëror publike dhe jopublike, 2019

Gjithashtu rezultojnë se, që prej datës 10.06.2017 (datë kur ka hyrë në fuqi ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës") janë kthyer pranë familjes 33 fëmijë ndërsa janë birësuar 19 fëmijë (brenda dhe jashtë vendit) ndërsa 4 fëmijë janë në pritje të procedurave të birësimit.

## Arsimimi në shtëpi për fëmijët që nuk mund të shkojnë në shkollë

**DRAP Durrës** pohon se për periudhën 2019 - 2020 nuk kemi patur raste të nxënësve të identifikuar për nevojë për arsimimin në shtëpi, përveç periudhës së pandemisë, ku mësimi në shtëpi u zhvillua për të gjithë nxënësit.

Gjithashtu, nga **DRAP Fier dhe Lezhë** pohohet se nuk kanë raste fëmijësh romë dhe egjiptianë të cilët nuk mund të shkojnë në shkollë.

Në ZVAP-ët në varësi të **DRAP Korçë** nuk ka patur shërbim në shtëpi të fëmijëve të detyrimit shkollor, romë dhe egjiptianë me përjashtim të rasteve të fëmijëve me AK.

## Bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile

**DRAP Durrës** thekson që në rastet e nxënësve romë dhe egjiptianë që nuk kthehen në shkollë komunikohet me Njësitë Vendore, dhe Njësinë e Mbrojtjes së fëmijëve me Shoqata apo Organizata jofitimprurëse për të bërë të pa mundurën për rikthimin e tyre në shkollë.

Gjithashtu, **DRAP Lezhë dhe Korçë** pohojnë bashkëpunim e plotë me shoqata dhe organizata që veprojnë në të gjithë njësitë vendore që e kanë fokusin tek fëmijët romë dhe egjiptianë, si dhe me punonjësit e shërbimit socialë të bashkive respektive.

Nga **DRAP Fier** raportohet se ka bashkëpunim ndërmjet disa ZVA-ve të vartësisë dhe shoqatave të komunitetit romë dhe egjiptianë. Njësitë e shërbimit psiko-social organizojnë veprimtari sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere me shoqata të ndryshme për identifikimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë. Ndërkohë theksojmë se në ZVA Lushnje asnjë organizatë e shoqërisë civile për identifikimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë nuk i është ofruar shkollave për bashkëpunim.

## Braktisja shkollave nga fëmijët romë dhe fëmijët egjiptianë

Procedura që ndjekin Drejtoritë Rajone Arsimore Parauniversitare për të marrë informacion nga Drejtoritë e shkollave dhe për të raportuar për braktisjet nga çdo shkollë të fëmijëve romë dhe egjiptianë janë:

**DRAP Durrës** - IAP-të raportojnë pranë ZVA-ve, çdo muaj për të gjithë nxënësit braktisës, përfshirë dhe për ata romë e egjiptianë, si dhe shkakun e braktisjes së shkollës. Gjithashtu, IAP-të raportojnë

pranë NJMF-ve dhe këto të fundit pranë Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve. Pasi merret informacioni për çdo rast, ZVA në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave, shërbimin psiko-social, ekipin mësimor, përfaqësues të bordit, përfaqësues të komunitetit rom dhe e gjiptian, si dhe përfaqësues të njësisë bashkiake apo të komunave, kanë dalur në terren për rikthimin e nxënësve braktisës në shkollë.

**DRAP Fier**, çdo ZVA komunikon me drejtoritë e shkollave të vartësisë për të marrë informacion periodik për nxënësit me tendencë braktisjeje të shkollës dhe ata që nuk vijojnë frekuentimin e saj. Drejtoritë e shkollave kanë detyrim që buron nga rregullorja për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare (Dispozitave Normative në fuqi para vitit 2020) për të referuar në afatet e caktuara të gjitha rastet e braktisjes së arsimit të detyruar. Sipas nenit 76 të kësaj rregulloreje drejtoritë e shkollave raportojnë në fillim të javës së tretë të muajit tetor për nxënësit e regjistruar që nuk janë paraqitur në mësim. ZVA-të, në të gjitha rastet e raportimit për braktisje të arsimit të detyruar, njoftojnë bashkinë ku ndodhet shkolla për ndjekje të mëtejshme sipas kuadrit ligjor për përgjegjësitë prindërore dhe të drejtat e fëmijës.

**DRAP Lezhë**, përveç statistikës zyrtare periodike raportimi bëhet nga institucioni shkollor në ZVA-në përkatëse dhe për çdo rast të ndodhur në veçanti dhe ndiqet në bashkëpunim me NJMF që në momentet e para. Gjithashtu, nga referimi i rasteve në tryeza teknike multi-institucionale.

**DRAP Korçë**, në zbatim të Strategjisë së MASR "Mbi braktisjen shkollë", ZVA-të kanë hartuar planin e punës dhe kanë ndjekur me përparësi uljen e numrit të braktisjes shkollë. Shkollat monitorohen për frekuentimin e nxënësve dhe raportojnë tre herë në vit në lidhje me frekuentimin e nxënësve.

Pasi hartohet lista e nxënësve braktisës ose rrezik braktisjeje nga raportimet e shkollave në nivel ZVA-je shqyrtohen rastet e dërguara në tryeza teknike ku përfshihen dhe aktorë të tjerë. Gjithsesi, DRAP Korçë ka sjellë informacion vetëm në lidhje me ZVA Elbasan e cila ka marrë masa në bashkëpunim me NJMF e Bashkisë Elbasan, Drejtoria e Policisë, Institucioni i Prefektit, si dhe shoqatat e ndryshme që funksionojnë në Elbasan për sistemimin e tyre në shkollë.

### Covid - 19 dhe mësimi për fëmijët romë dhe fëmijët egjiptianë

Gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, Zyra Vendore Arsimore Durrës ka ndjekur me prioritet pjesëmarrjen e fëmijëve të komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian në mësimin online.

Gjatë kësaj periudhe mësuesit kanë punuar me të gjithë nxënësit e tyre edhe duke iu përshtatur nevojave specifike të çdo nxënësi përfshirë dhe nxënësit e komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian. Nxënësit romë dhe egjiptianë mësimet i kanë ndjekin online nga faqja e shkollës, "Platformat online".

IAP-të e ZVAP-ve nën juridiksionin e DRAP Durrës, gjatë periudhës së pandemisë, morën masa për të zhvilluar mësimin me të gjitha format online, grupet e ngritura nëpër telefona, facebook, orëve mësimore televizive, etj. Në veçanti, duke pasur parasysh që fëmijëve romë u mungonte aksesin në mjetet e teknologjisë (kompjuter, tablet apo telefona smart), MASR mundësoi pajisjen e një pjese të konsiderueshme të tyre, me telefonat smart dhe tablet.

**DRAP Fier** pohon se nga shkollat që mbulon nuk ka pasur formate të veçanta të mësimdhënies për nxënësit romë dhe egjiptianë gjatë mësimin në distancë në periudhën e pandemisë së COVID-19. Por, nxënës të këtij komuniteti, së bashku me nxënës të tjerë në pamundësi ekonomike për të ndjekur mësimin online nëpërmjet pajisjeve të përshtatshme, janë pajisur me telefona dhe tableta nga ZVA-të.

Përveç përfshirjes si për të gjithë nxënësit e tjerë nga shkollat që mbulon **DRAP Lezhë** për nxënësit romë dhe egjiptianë ka pasur dhe mbështetje nga MASR me mjete digjitale dhe internet për ndjekjen e mësimin si gjithë nxënësit e tjerë të sistemit arsimor.

Ndryshe nga DRAP-të e tjerë **DRAP Korçë** ka dhe statistika lidhur ndjekjen e mësimin online për fëmijët romë dhe egjiptianë.

Në ZVA Elbasan kanë ndjekur mësimin rregullisht nga shtëpia rreth 86.8% të nxënësve romë dhe 92% të numrit të nxënësve egjiptianë të regjistruar në shkollë. Nxënësit romë dhe egjiptianë kanë ndjekur mësimet nëpërmjet: TVSH, biseda telefonike, rrjetet sociale, dhe platformës online, etj.



## Aspekte të monitorimit të detyrimeve ligjore

### I. Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar raportojnë përvojën e tyre në zbatimin e marrëveshjen "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor të nënshkruan në vitin 2018 nga tri Ministrinë<sup>7</sup>.

Në të gjithë drejtoritë e IAP-ve të DRAP Durrës realizohet një bashkëpunim efikas ndër-institucional për monitorimin dhe realizimin e përfshirjes shkollore për të gjithë fëmijët që janë nën juridiksionin e Njësisë Vendore të tyre. Për këtë, ka komunikime të vazhdueshme dhe verifikime nga njësitë vendore, shkollat e arsimit bazë, nga arsimit parashkollor dhe Qendra Shëndetësore për identifikimin e çdo fëmije në moshë shkollore dhe përfshirjen e tyre në arsimin e detyrueshëm. Njëkohësisht, bashkëpunim ka dhe me organizatat jo-fitimprurëse që funksionojnë në zonë. Në momentin që merret informacion për fëmijë të cilët nuk janë të regjistruar në shkollë, të gjitha strukturat bashkëpunojnë për përfshirjen e fëmijës në arsim.

Megjithëse ZVA-të e vartësisë së **DRAP Fier** e kanë kryer detyrën e tyre për identifikimin e fëmijëve që mbushin moshën për regjistrim në klasën e parë, institucionet e tjera si bashkia dhe policia nuk janë angazhuar për të finalizuar procesin. Në këtë mënyrë regjistrimi i këtyre fëmijëve në shkollë në shumë raste nuk është arritur, të paktën jo sipas procedurës së përcaktuar në marrëveshjen mes tri ministrive.

**DRAP Lezhë** pohon se me ardhjen e listës nga Ministria e Brendshme, ngrihen grupet e punës pranë ZVA-ve dhe IAP-ve, të cilat fillojnë identifikimin dhe regjistrimin e nxënësve që kanë mbushur moshën e detyrimit për klasën parë.

Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, të gjithë nxënësit e mbetur pa regjistruar dhe të paidentifikuar, në shtator dërgohet lista pranë Bashkisë dhe Komisarariatit të Policisë për identifikimin e vendndodhjes së tyre.

Në këtë proces bashkëpunojnë dhe aktorë të tjerë si Observatori për Mbrojtjen e Fëmijëve, OJF, Prefekturat dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore.

**DRAP Korçë** pohon se mbështetur në marrëveshjen e Ministrive, "ZVA Korçë - Pustec ka planifikuar veprimtaritë në bazë të rolit dhe përgjegjësive të përcaktuara në këtë marrëveshje:

- Identifikimi i fëmijëve me probleme në familje që rrezikojnë të mos regjistrohen në shkollë në bashkëpunim me NJMF.
- Grumbullimi i informacionit nga shkollat për fëmijët që janë në rrezik braktisjeje, identifikimi i problematikave dhe komunikimi me NJMF dhe Grupin Multifunksional për mbrojtjen e fëmijëve.
- Përpunimi dhe mbledhja e listave të raportuara nga shkollat mbi regjistrimet në klasë të parë.
- Dërgimi me shkresë zyrtare dhe format elektronik i listës së fëmijëve të peregjistruar në klasë të parë me të dhënat për çdo fëmijë tek Bashkia, Komisarati i Policisë dhe Prefektit.
- Ndjekja e procesit të regjistrimit në shkollë të fëmijëve të peregjistruar të identifikuar nga përgjegjësi njësisë administrative dhe punonjësi i policisë së zonës.
- Hartimi i listës së fëmijëve të paidentifikuar nga përgjegjësit e njësive administrative dhe nga punonjësit e policisë së zonave apo që rezultojnë të transferuar dhe dërgimi i kësaj liste pranë QSHA.

<sup>7</sup> Marrëveshje Bashkëpunimi midis MASR, MB, MSHMS e vitit 2018, "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor".

## II. Evidentimi dhe raportimi i problematikave nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar për zbatimin e strategjive dhe të planeve kombëtare, të cilat lidhen me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët romë dhe egjiptianë në fushën e arsimit parauniversitar për vitin arsimor 2018 - 2019 dhe 2019 - 2020.

**DRAP Durrës** raporton ndër problemet kryesore për vitin shkollor 2018 - 2019 dhe 2019 - 2020:

- Probleme social - ekonomike të familjeve të nxënësve,
- shfrytëzimi i fëmijëve për punë të ndryshme,
- ndryshimi i herë pas hershëm i vendbanimit dhe nënvlerësimi për shkollimin e fëmijëve.
- Fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian shfaqin herë pas here braktisjen e shkollës, kjo vjen edhe si pasojë e mos interesit për arsim, të reflektuar nga komunikimet e ndryshme me prindërit.
- Numri i pakët i mësuesve ndihmës sidomos në vitin 2018-2019.
- Mungesa e mësuesve të profilit Pedagogji Speciale. Numri i mësuesve të këtij profili ka qënë shumë i ulët duke e krahasuar me nevojën e vlerësuar për nxënësit me aftësi të kufizuara. Në mungesë të mësuesve të profilit pedagogji speciale, janë punësuar mësues në profile të përafërta të cilët janë trajnuar dhe vazhdojnë të trajtohen në vazhdimësi për të bërë të mundur plotësimin e nevojave të këtyre fëmijëve.
- Kundërshtimi i prindërve për të diagnostikuar fëmijët me AK dhe për rrjedhojë IAP nuk disponon raport mjekësor.
- Mungesa e fondeve specifike të shkollave për plotësimin e nevojave të nxënësve me aftësi ndryshe.

**DRAP Fier** raporton se nuk janë evidentuar problematika të tjera në zbatimin e strategjive që lidhen me fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët romë dhe egjiptianë.

**DRAP Lezhë**, për vitin shkollor 2018 - 2019 dhe 2019 - 2020 ka evidentuar dhe raportuar në DPAP Tiranë dhe MASR problemet që lidhen me gjendjen sociale të fëmijëve me aftësi ndryshe si dhe vështirësitë që hasen në integrimin e tyre në shkollë, familje dhe shoqëri. Gjithashtu, janë raportuar problematika që lidhen me fëmijët në situatë rruge, mbrojtja e fëmijëve nga trafikimi, për fëmijët e kthyer nga emigracioni, dhuna në familje ndaj fëmijëve, si dhe raportimi të marrjes së shërbimit arsimor online për fëmijët me AK.

**DRAP Korçë** raporton në problematikat për fëmijët me AK që ZVA-të janë përpjekur për ti eliminuar dhe që lidhen me zbatimin e strategjive dhe planeve kombëtare për fëmijët romë dhe egjiptianë si: duke u siguruar të gjithë nxënësve me AK mësues ndihmës në përshtatje me nevojat e tyre në klasat gjithëpërfshirëse.

Problematika për fëmijët romë dhe egjiptianë kanë qënë mos frekuentimi sistematik i nxënësve romë dhe egjiptianë (duke nxjerrë pretekst arsyet ekonomike); tek shkollat me ndihmë ushqimore nxënësit frekuentojnë vetëm orët e para të mësimit, pasi marrin racionin ushqimor, nxënësit largohen nga shkolla; pamundësi e prindërve për t'ju ofruar mbështetje akademike gjatë studimit në shtëpi; mosfrekuentimi i rregullt i programit "Bëjmë detyrat në shkollë" për arsye mosdëshire; mungesa e përfundimit të klasave të larta të Arsimit të Mesëm të Ulët veçanërisht nga vajzat romë për arsye mentaliteti.

**III. Monitorimi i DRAP-ve mbi detyrimet e Drejtuesit të institucionit arsimor të cilat rrjedhin nga neni 19, i Ligjit Nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në R.Sh", i ndryshuar, dhe Ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar.**

Sipas raportimit të DRAP-ve:

Sektori i monitorimit të kurrikulës dhe cilësisë pranë Zyrave Vendore Arsimore apo sektorët pranë **DRAP Durrës** ndjekin me përparësi çdo informacion që paraqitet nga shkollat për nxënësit me aftësi ndryshe apo që i përkasin komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian, merr masat e nevojshme për mbrojtjen nga diskriminimi i tyre, jep rekomandime të përvitshme tek drejtuesit e shkollave për mbrojtjen e fëmijëve nga diskriminimi dhe ndërmerr hapa të vazhdueshme që të gjithë fëmijët të ndjehen të barabartë në çdo institucion arsimor. Në platformat e monitorimit ka pika të veçanta ku kërkohet zbatimi i udhëzimeve për regjistrim në arsimin e detyruar.

Drejtoritë e IAP-ve të DRAP Durrës kanë marrë masa për afishimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në një vend të dukshëm, kanë trajtuar me efikasitet ankesat për diskriminim dhe i shqyrtojnë me përparësi.

Nëpërmjet bashkëpunimit me shërbimin psiko-social jep rekomandime të përvitshme tek drejtuesit e shkollave për mbrojtjen e fëmijëve nga diskriminimi dhe ndërmerr hapa të vazhdueshme që të gjithë fëmijët të ndjehen të barabartë në të gjithë shkollat në varësi të ZVA-ve nën juridiksionin e DRAP Durrës.

**DRAP Fier** dhe ZVA-të vartëse kanë marrë informacion mbi zbatimin e detyrimit që drejtoritë e shkollave kanë për të afishuar në mjediset e shkollës Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ndërkohë nuk ka pasur ndonjë rast problematik të evidentuar të shkeljes së këtij ligji. Deri tani nuk janë kryer monitorime të posaçme për detyrimet e drejtorëve të shkollave sipas nenit 19 të ligjit.

**DRAP Lezhë**, pohon se nga të gjitha njësitë vendore arsimore monitorohen detyrimet që ka drejtuesi i institucionit arsimor në zbatim të ligjit 10221, datë 04. 02. 2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar

**DRAP Korçë** thekson, drejtuesit e institucioneve arsimore pranë ZVA-ve monitorohen përmes platformave të ndryshme të monitorimit:

- Për zbatimin e Ligjit Nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.
- Për masat e marra në fillimin e vitit të ri shkollor: regjistrimin e nxënësve të moshës së detyrimit shkollor.
- Pajisja me tekste të nxënësve
- Frekuentimin e nxënësve dhe shqyrtimin e arsyeve të mos frekuentimit.
- Funksionimin e procesit mësimor - edukativ në shkolla.
- Gjithëpërfshirja
- Funksionimi i komisionit psiko-social në shkolla etj.

**“Aksesi në shkollim  
dhe  
mësimnxënie cilësore  
është  
një e drejtë themelore.”**

## KONKLUZIONE

Konkluzionet e këtij monitorimi do të ndahen në katër kategori: mbi informacionin e DRAP-ve, mbi fëmijët me aftësi të kufizuara, mbi fëmijët romë dhe fëmijët egjiptianë.

*Në lidhje me të dhënat që institucionet duhet të disponojnë.*

Nisur nga raportimet e Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar, vërehet nevoja për të dhëna të besueshme, sistem transparent, publik dhe të integruar të menaxhimit të të dhënave në arsimin parauniversitar për fëmijët me AK, fëmijët romë dhe fëmijët egjiptian. Përdorimi i treguesve jo plotësisht të saktë vështirëson monitorimin dhe vlerësimin e aspekteve të ndryshme të arsimit. Duhet të ketë një sistem statistikash të përditësuar dhe të unifikuar në mënyrë më efçente nga institucionet e DRAP. Mbledhja e këtyre statistikave duhet të ketë një qasje të re metodologjike.

Rezulton që institucionet përgjegjëse, DRAP-të, nuk ndjekin një sistem të unifikuar të mbledhjes të të dhënave, ndarjes në kategori, raportimit dhe publikimit të tyre.

DRAP-të janë kontradiktore në komunikimin e këtyre të dhënave dhe nuk rezulton që të kenë një sistem informacioni efektiv. Gjithashtu, DRAP-të jo rrallë herë nuk sjellin informacionin e kërkuar dhe komunikojnë që nuk e disponojnë.

Edhe pse janë miratuar akte nga Këshilli i Ministrave mbi periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave, rezulton që këto akte kanë mbetur të pazbatuara ndër vite.

Mospasja e një sistemi të mirë organizuar të mbledhjes së të dhënave, ndarjes së tyre sipas specifikave, unifikimit të majtjes dhe raportimit të tyre, nuk lejon të kuptuarit qartë situatën faktike të arsimit në Republikën e Shqipërisë.

*Në lidhje me nxënësit me aftësi të kufizuara*

Monitorimi tregoi se fëmijët me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me sfida në sistemim arsimor shqiptar.

Parimi i arsimit gjithëpërfshirës është pranuar gjerësisht në legjislacion, por zbatimi i tij ndeshet me pengesa të shumta. Shkolla duhet të reflektojë komunitetet që ka shoqëria, pasi kjo i ndihmon fëmijët për t'u rritur dhe për të pranuar shumëllojshmërinë e shoqërisë, si dhe për të mos diskriminuar individë apo grupe të ndryshme.

Legjislacioni shqiptar u ngarkon detyra të rëndësishme njërive arsimore rajonale dhe vendore (DRAP/ZVAP), si dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, lidhur me mënyrën, se si duhen asistuar dhe krijuar kushtet e nevojshme dhe të përshtatshme në mësimdhënie për nxënësit me aftësi të kufizuara. Qëllimi kryesor i legjislacionit në tërësinë e tij, është krijimi i të gjithë kushteve të nevojshme, që fëmijët të mund të arsimohen njëjloj si të gjithë fëmijët e tjerë, si dhe përfshirja dhe integrimi i tyre në institucionet arsimore të zakonshme. Transformimi i shkollave në një mjedis gjithëpërfshirës nënkupton planifikimin e shumë aktiviteteve dhe është një proces që varet nga mbështetja e shoqërisë, reforma e kurrikulës, organizimi i shkollës, trajnimet e mësuesve, dhe ofrimi i shërbimit mbështetës të specializuar, krijimi i infrastrukturës.

Arsimi gjithëpërfshirës vitet e fundit është shndërruar në një fenomen delikat që ndikon në cilësinë e jetës së shumë individëve.

Aftësia e kufizuar nuk shihet më vetëm si një problem i familjes, por i shkollës, shoqërisë dhe komunitetit.



Edukimi parashkollor është i domosdoshëm dhe i pazëvendësueshëm për arsimimin e fëmijëve, por për fëmijët me aftësi të kufizuara që kanë përfunduar arsimin parashkollor të ndarë sipas llojit të aftësisë së kufizuar dhe gjinisë nuk ka raporte të sakta nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar.

Jo të gjitha Institucionet Arsimore janë të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Rezulton që rreth 60 % e shkollave në të gjithë Republikën e Shqipërisë konsiderohen që garantojnë aksesin fizik të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Por, edhe në këto shkolla jo e gjithë godina është e aksesueshme në pjesën më të madhe vetëm katet e para.

Në shkollat që ka nxënës me AK dhe nuk ka akses për lëvizshmërinë e tyre, ata ndihmohen nga prindërit dhe mësuesit për të mundësuar vijimin e procesit mësimor, ndërsa në shkollat e zonave rurale që nuk kanë hyrë në proces rikonstruksioni, nxënësve u ofrohet mësimi në shtëpi.

Shkollat nuk e kanë infrastrukturën e duhur për nxënësit me probleme në shikim. Në arsimin bazë nuk ka libra mësimorë për fëmijët që nuk shikojnë. Mësuesit kujdestar, mësuesit e lëndëve të ndryshme apo edhe mësuesit ndihmës nuk e njohin alfabetin BRAIL ose në format dixhital.

Gjithashtu, në institucionet arsimore të zakonshme nuk ka mjete didaktike për fëmijët që nuk dëgjojnë. Fëmijët që nuk dëgjojnë përdorin më së shumti gjuhën e shenjave për të komunikuar me stafin arsimor dhe nxënësit në shkollë. Specifikisht, ata kanë nevojë për trajnim në përdorimin e gjuhës së shenjave.

Shkollave në tërësi u mungojnë ambjentet e dedikuara për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale.

Në shkolla nuk ka mësues të përgjithshëm apo mësues ndihmës që janë të trajnuar për përdorimin e gjuhës së shenjave. Cilësia e arsimit ndikohet nga nevoja për rehabilitimin e vazhdueshëm të shkollave, përmirësimin e pajisjeve, trajnimin e mësuesve dhe mbështetjen e veprimtarive shkollore.

Për fëmijët të cilët, për nevoja të veçanta të zhvillimit, që nuk mund të ndjekin mësimin në institucione arsimore, zhvillimi i mësimin në kushtet e shtëpisë është realizuar me rekomandim të Komisionit Multidisiplinar për AK dhe PEI, duke bërë të mundur zhvillimin e mësimin me grupe mësuesish sipas lëndëve përkatëse.

Procesi i mësimdhënies për mësuesit është lehtësuar përmes instrumenteve alternative si PEI, i cili hartohet nga mësuesi kujdestar i nxënësit me AK, me psikologun/punonjësen sociale shkollore në përputhje me nevojat dhe mundësitë e fëmijës.

Nga pikëpamja e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve në shkollë mësuesit kanë një bashkëpunim të fortë me prindërin. Mësuesit qëndrojnë si një urë lidhëse komunikimi për progresin e fëmijës me AK. Ata mbeten faktorë shumë i rëndësishëm për ndjekjen dhe ecurinë e nxënësit me AK dhe ndërveprimin të tij me bashkëmoshatarët.

Megjithatë, mungesa e njohurive të specializuara, kualifikimeve praktike dhe teknikave konkrete për të punuar me fëmijë me AK e vështirëson punën e mësuesëve të përgjithshëm në mësimdhënie. Mësuesit e specializuar, si dhe mësuesit që kanë mbaruar arsimin e lartë të specializuar janë shumë të paktë.

Gjithashtu, akoma nuk plotësohen të gjitha nevojat dhe kërkesat e DRAP-ve në lidhje me sasinë e mësuesve ndihmës që kërkojnë.

Në disa DRAP rezulton që nuk korrespondojnë PEI të përgatitura me numrin e nxënësve me aftësi të kufizuar, si dhe jo të gjitha DRAP-të kryejnë monitorime për zbatimin e PEI.

### Në lidhje me nxënësit e komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian.

Shqipëria i ka shtuar investimet për përmirësimin e gjithëpërfshirjes, si çështje kyçe e politikës, në pajtim me qëllimet kombëtare. Sipas të dhënave është rritur ndjeshëm pjesëmarrja e fëmijëve të komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian në të dyja nivelet e arsimit parauniversitar, por edhe parashkollor.

Gjithsesi, akoma evidentohen shifra të konsiderueshme fëmijësh të këtyre komuniteteve të paregjistruar, veçanërisht në zonat rurale.

Është për tu evidentuar edhe fakti që në arsimin e mesëm janë shumë të paktë fëmijët, sidomos të komunitetit rom që regjistrohen dhe vazhdojnë studimet.

Rezulton që fëmijët egjiptianë janë më të përfshirë në arsim, si dhe ato kanë një përqindje më të lartë vazhdimi të shkollës së mesme. Por, numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë që vazhdojnë arsimin e mesëm mbetet në një nivel shumë të ulët dhe kjo padyshim reflektohet edhe në arsimin e lartë.

Trajtimi i problemit të arritjeve të ulëta arsimore, duke përfshirë braktisjen e hershme dhe analfabetizmin, është një domosdoshmëri e qartë për parandalimin e papunësisë në të ardhmen, të varfërisë, situatat e pasigurta të strehimit dhe faktorë të tjerë që do të forcojnë më tej përjashtimin shoqëror. Në këtë kontekst, është pozitive të shihet që autoritetet kanë përfshirë masa gjithëpërfshirëse, duke filluar me përpjekjen për të regjistruar më

shumë fëmijë romë dhe egjiptianë në arsimin parashkollor dhe të detyrueshëm.

Edhe pse në rritje fëmijët romë dhe fëmijët egjiptianë kanë një shkallë frekuentimi të ulët për shkak të një sërë faktorësh, siç janë kërkesa nga prindërit e tyre për të punuar në mënyrë që të plotësojnë të ardhurat e varfëra të familjes, ose duke qenë të demoralizuar nga praktikat diskriminuese ndaj tyre.

DRAP-të kanë treguar një ndjeshmëri më të madhe gjatë raportimit për rrezikun e segregimit të fëmijëve romë dhe fëmijëve egjiptianë.

Edukimi parashkollor është i domosdoshëm dhe i pazëvendësueshëm për arsimimin e fëmijëve. Nga informacionet e KMD-së rezulton se për vitin arsimor 2018-2019, sa i përket tarifave të regjistrimit të fëmijëve rom apo egjiptian në kopësht, nga 61 Bashki, rezultoi se 11 prej tyre e kanë regjistrimin e fëmijëve në kopësht pa pagesë, 5 prej tyre kishin kopshte me drekë, të cilat kishin edhe regjistrimin pa pagesë dhe 45 prej tyre nuk kanë dhënë informacion nëse kanë vendosur tarifa për regjistrimin e fëmijëve në kopshte.

## REKOMANDIME

Në përfundim të monitorimit dhe të problematikave të konstatuara për një arsim gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët romë dhe fëmijët egjiptianë, konstatohet se gjendja e respektimit të të drejtave dhe lirive të këtyre nxënësve, ka nevojë për përmirësim.

Nga analiza dhe vlerësimet e sipërpërmendura Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon:

Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), të ndërtimit të një sistemi të qartë, të organizuar, të unifikuar, të mbledhjes së të dhënave në lidhje me nxënësit me aftësi të kufizuara, nxënësve romë dhe nxënësve egjiptianë në arsimin bazë dhe të mesëm.

Marrjen e masave nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për ndjekjen e zbatimit të Vendimit KM Nr. 708, datë 26.8.2015 “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”, përmes të cilit ngarkohen institucionet përgjegjëse që të mbledhin të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar, dhe veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara në fushën e edukimit, sipas treguesve të kërkuar për llojin e statistikave. Këto të dhëna kanë si qëllim hartimin, përmirësimin dhe zbatimin e politikave në mbështetje të programeve të aksesit dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara, dhe në këtë kuadër do të shërbejnë edhe në mbështetje të fëmijëve me aftësi të kufizuara në fushën e arsimit.

Marrjen e masave nga MASR për të siguruar një monitorim të vazhdueshëm dhe proaktiv të procesit të arsimit gjithëpërfshirës, me qëllim eliminimin e barrierave që pengojnë të drejtën për arsimim, të fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijëve romë dhe fëmijëve egjiptianë, për të përshtatur nevojat dhe për të garantuar përfshirjen e fëmijëve në arsim gjithëpërfshirës, cilësor dhe efektiv.

Marrjen e masave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për përshtatjen e të gjitha institucioneve arsimore në juridiksionin e tyre në mënyrë që të garantojnë aksesueshmërinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Marrjen e masave nga ana e MASR për monitorimin nga afër të infrastrukturës së shkollave, sidomos në lidhje me aksesin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe bashkëpunimin e me njësinë e vetëqeverisjes vendore për realizimin e plotë të kësaj infrastrukture sipas legjislacionit në fuqi.

Marrjen e masave për të garantuar mbrojtjen nga diskriminimi, në mënyrë të veçantë për vajzat me aftësi të kufizuara, si dhe për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara, që i përkasin grupeve të disavantazhuara, siç janë fëmijët me aftësi të kufizuara romë, egjiptianë, fëmijët me aftësi të kufizuara nga familjet e varfra.

Këto kategori fëmijësh janë të rrezikuara për të përjetuar situata diskriminuese më të rënda, për pasojë të ndërveprimit apo mbivendosjes së më shumë se një shkakut të mbrojtur të diskriminimit.

Marrjen e masave për të siguruar ngritjen dhe funksionimin e Komisioneve Multidisiplinare në nivel ZVA brenda afateve të përcaktuara, si dhe Komisionet në institucionet arsimore të zakonshme. Përcaktimin e rregullave dhe procedurave për funksionimin e komisioneve si më sipër, si dhe përcaktimin e detyrimeve dhe përgjegjësive për mospërmbushjen e detyrimit për ngritjen dhe funksionimin e Komisioneve Multidisiplinare, si në nivel ZVA ashtu edhe në nivel shkolle.

Marrjen e masave, për përgatitjen e Planeve Edukative Individuale (PEI), sipas nevojave të vlerësuara të fëmijëve me aftësi të kufizuara nga komisionet multidisiplinare, si dhe marrjen e masave për mbështetjen me mësues ndihmës të kualifikuar, sipas nevojave të vlerësuara të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Marrjen e masave për programe kualifikimi dhe trajnime në rang vendi për mësuesit e shkollave, me qëllimin që të pajisen me një paketë njohurish të specializuara teorike dhe praktike në fushën e aftësisë së kufizuar.

Marrjen e masave për plotësimin e të gjitha nevojave të DRAP-ve për mësues ndihmës sipas kërkesave të tyre.

Marrjen e menjëhershme të masave për përfshirjen në sistemin arsimor të personave që kanë mbaruar arsimin special.

Me qëllim që të gjitha masat e mësipërme të jenë efektive, veçanërisht për vitin shkollor pasardhës, vlerësojmë se ato duhet të realizohen në një kohë sa më të shkurtër.

Marrjen e masave për evidentimin e fëmijëve romë dhe fëmijëve egjiptianë të paregjistruar, të pavaksinuar dhe që nuk frekuentojnë kopshtet/shkollat.

Të merren masa nga njësite e vetëqeverisjes vendore në bashkëpunim me të gjithë aktorët publikë dhe shoqërorë, për rritjen e numrit të fëmijëve të regjistruar nga komuniteti rom dhe komuniteti egjiptian në të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar duke garantuar një arsim më cilësor, si dhe mënjanimin e sjelljeve dhe qëndrimeve stigmatizuese dhe përjashtuese për këta fëmijë. Rritja e kapaciteteve të institucioneve për të nxitur pjesëmarrjen dhe regjistrimin e komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian në arsimin e mesëm.

Gjithashtu, të nxitet dialogu ndërkulturor përmes aktiviteteve të ndryshme për promovimin e kulturave, identitetit rom dhe egjiptian dhe bashkëjetesës harmonike të trashëgimisë kulturore, si dhe informimin dhe ndërgjegjësimin e prindërve dhe të komuniteteve rome dhe komuniteteve egjiptiane për rëndësinë e arsimit.

Marrjen e masave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për numrin total të popullsisë rome dhe egjiptiane që banojnë në territorin e tyre dhe mbajtjen e të dhënave në mënyrë korrekte dhe të qartë. Një numër i saktë i këtyre familjeve, do të shërbejë për të planifikuar politika sociale dhe për të bërë të mundur regjistrimin e fëmijëve në institucionet arsimore. Numri i fëmijëve 0-3 vjeç identifikon fëmijët të cilët mund të regjistrohen në çerdhe, 3-6 vjeç do të ndihmojë ZVA-të dhe Bashkinë për regjistrimin e tyre në kopshte dhe klasa përgatitore, 6-15 vjeç evidenton numrin e atyre që janë frekuentues ose që duhet të regjistrohen në arsimin e detyruar bazë.

Marrjen e masave nga MASR për zbatimin e Dispozitave Notmative në lidhje me regjistrimin e fëmijëve në shkolla, sidomos duke ndjekur kriterin e vendbanimit.

Gjithashtu, marrjen e masave për mbajtjen e statistikave të qarta për numrin e fëmijëve rom dhe fëmijëve egjiptian në çdo IAP, dhe monitorimin e tyre me qëllim shmangien në kohë të tendencave segreguese që mund të evidentohen.

Marrjen e masave nga MASR për sigurimin e transportit për të gjithë fëmijët që ndjekin arsimin bazë dhe të mesëm, me aftësi të kufizuar, fëmijë të komunitetit rom, fëmijët e komunitetit egjiptian, fëmijët në pamundësi ekonomike dhe fëmijët që ndjekin arsimin në shkolla në zonat ruale. Për këtë qëllim, distanca prej 2 km duhet rikonsideruar dhe të pakësohet dhe të bëhet i mundur garantimi efektiv i sigurimit të transportit për fëmijët e sipërpërmendur.

MASR të marrë masat për afishimin e përmbledhjes së Ligjit Nr.10221 datë 4.2.2010, të ndryshuar, në formate të kuptueshme nga fëmijët dhe të aksesueshme për të gjitha kategoritë e fëmijëve.